

XHEJN OSTEN  
**KRENARI & PARAGJYKIM**  
ROMAN

---

**BOTIMET TOENA**



XHEJN OSTEN

KRENARI dhe PARAGJYKIM

ROMAN

Përktheu

Enit Steiner - Karafili

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2007

## FALËNDERIME

*Përfitoj nga rasti të shpreh mirënjohjen ndaj dy instituteve që kanë kontribuar në formimin tim si njohëse dhe përkthyes e Xhejn Osten, Universitetit të Cyrihut dhe atij të Los Anxheles (UCLA). Njëkohësisht, ia dedikoj këtë punim prindërve të mi, të cilët më kanë ushqyer dashurinë për librin*

Titulli i originalit: Jane Austen *Pride and prejudice*

Botues: Fatmir Toçi

Redaktor: Çerçiz Loloçi

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 306 - 8

© Të drejtat e këtij përkthimi, shënimeve dhe i parathënies i përkasin përkthyeses Enit Steiner - Karafili

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollështa", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117


E-mail: [toena@toena.com.al](mailto:toena@toena.com.al); [info@toena.com.al](mailto:info@toena.com.al)

[toena@icc-al.org](mailto:toena@icc-al.org)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

XHEJN OSTEN

KRENARI dhe PARAGJYKIM



Shtëpia e Çatsworthit në Darbishër, Angli, marrë nga: Black's  
Guide to Derbyshire, Adam and Charles Black, Edinburgh, 1866.





Jane Austen: Portret (1870) i bazuar në një skicë të vizatuar nga e motra në 1810.





## PARATHËNIE

**K**ur dëgjon emrin e Shekspirit, lexuesi shqiptar tund kokën i sigurtë dhe është gati të citojë Hamletin: - Të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja. Të tjera perla të letërsisë angeleze si - *Udhëtimet e Guliverit* - (Suift), - *Rob Roy* - (Valter Skot) janë ndoshta më pak të njohura, por nuk i kanë shpëtuar vëmendjes së lexuesit të interesuar.

Publiku shqiptar nuk e fut Xhejn Osten në këtë grup shkrimtarësh, por përkundrazi mbetet i habitur kur ballafaqohet me faktin që në përgjithësi kritikët letrarë e konsiderojnë romancierën më të madhe angleze dhe vepra e saj është krahasuar me atë të Shekspirit për vlerën universale që paraqet. Një kërkim sipërfaqësor në internet mjafton për të ndeshur një sërë shoqatash të themeluara në kujtim të shkrimtares. Në një kohë që shifrat e botimeve tregojnë që vepra e saj i ka rezistuar kohës si rrallë të tjera, lind natyrshëm pyetja se si shpjegohet që Xhejn Osten nuk njihet në Shqipëri. Është e vështirë, në mos e pamundur, t'i jepet një përgjigje e saktë kësaj pyetjeje. Një hamendje e guximshme, por jo pavend, ka të bëjë me qenien e saj femër; një noveliste, talenti i së cilës nuk përputhej me imazhin e artistit të popullit gjatë viteve të diktaturës komuniste. Shkrimtarë të tillë si Dikensi apo Suifti ishin shumë më të pranueshëm, sepse merrnin në shënjestër

shoqërinë kapitaliste angleze, ndërsa talenti i Xhejn Osten nuk ka qenë në shërbim të asnjë ideologjie dhe gjëja që eviton më shumë janë moralizmat, pavarësisht se kritika sociale nuk mungon kurrë. Kjo është pika kryesore ku ajo ndryshon nga të tjerët, sepse kritika e saj është nën rrogë, ironia është aq e hollë sa edhe therëse dhe pikësnyimi i saj është njëkohësisht shoqëria e shekullit XVIII, po aq sa edhe natyra njerëzore. - *Krenari dhe paragjykim* - ilustron fare mirë interesin dhe talentin e novelistes. Por para se t'i dedikohemi kësaj vepre, le të themi dy fjalë rreth Xhejn Osten.

\*\*\*

Xhejn Osten u lind më 1775 në Angli, në Stiventon, në vigjiljen e Luftës së Pavarësisë Amerikane. E ëma vinte nga një familje e aristokracisë së vogël, ndërsa i ati, nëpërmjet profesionit të tij, pastor protestant<sup>1</sup> dhe martesës me një grua të një rangu më të lartë se ç'ishte vetë, arrin të fitojë emrin xhentëlmen (angl. *gentleman*). Disa kritikë e konsiderojnë me prejardhje aristokrate, të tjerë e mohojnë këtë fakt duke argumentuar se familja nuk kishte të ardhurat dhe nuk bënte jetën e një familjeje aristokrate. Ajo rritet me pesë vëllezër dhe një motër. E para gjë që i bie në sy biografit është fakti që familja Osten ishte një familje shumë e lidhur, aq sa vëllezërit, nipat e mbesat janë mobilizuar pas vdekjes së Xhejn Osten të nxjerrin për botim veprat e pabotuara dhe të përmbledhin kujtimet e shkrimtares. Përmbledhja e korrespondencës së saj, e cila është botuar pas vdekjes, fillimisht ka kaluar në duart e së motrës, Kasandra Osten, e cila për të ruajtur sferën private të shkrimtares asgjësoi një numër të madh të tyre.

---

<sup>1</sup> Homologu protestant i priftit katolik.

Xhejni fillon të ushtrojë letërsinë që në moshën 12-vjeçare dhe për më se shtatë vjet shkruan atë pjesë të veprës së saj që sot quhet - *Vepra rinore - (Juvenilia)*, ku përfshihen novela dhe skeçe të shkurtra. Kjo pjesë e veprës, edhe pse fillestare, bie në sy për humorin dhe cinizmin që do të mbetet shenja dalluese e stilit të Xhejn Osten. Po ashtu si Oskar Uajld, ajo është e bindur që humori është shpesh më efikas sesa serioziteti, sepse aty ku qeshet ka për të mësuar. “*Është e pamundur të mos ndeshet herë pas here zgjuarsi te një person që të zbavit*”, - shkruan ajo.

Ndërmjet viteve 1795-1817, Xhejn shkruan - *Arsye dhe ndjenjë* - (1811), - *Krenari dhe paragjykim* - (1813), - *Parku i Mensfildit* - (1814) dhe - *Ema* - (1816). Princ Regjenti i kërkon shkrimtares dedikimin e romanit - *Ema* -<sup>1</sup>, gjë që Xhejn Osten pranon, pavarësisht se nuk është simpatizante e tij, për shkak të jetës së tij të shthurur. Pa dyshim që ky dedikim, shenjë e përkrahjes së një personi kaq të rëndësishëm, ia rriti prestigjin shkrimtares. - *Manastiri i Northangerit* - dhe - *Bindje* - botohen në vitin 1818, pas vdekjes së autores. Krijimtaria e Xhejn Osten ndërpritet në moshën 41-vjeçare gjatë shkrimit të romanit të fundit, *Sanditon*. Po ta kishte përfunduar, ky roman do të kishte shënuar me siguri kurorëzimin e veprës së saj. Arsyeja e vdekjes është e paqartë, dyshohet nga tuberkulozi ose kanceri i gjirit.

---

<sup>1</sup> Princi Regjenti, i njohur si Xhorxhi IV, ishte djali i Xhorxh III, mbretit të Anglisë dhe zuri vendin e të atit, për shkak të sëmundjes psikike të këtij të fundit. Princ Regjenti ka qenë një nga sovranët më liberalë të monarkisë angleze. Antipatia që Xhejn Osten kishte për të shpjegohet mbi të gjitha me keqtrajtimin që ai i ka bërë së shoqes, Karolinës, me të cilën u martua vetëm për interesa politike. Falë mediave, ky ka qenë çifti i parë mbretëror, konfliktet e të cilit populli anglez i ka ndjekur nga afër. Bibliotekari i Princit dëshmonte që sovranit e vlerësonte dhe mbante kopje të librave të Xhejn Osten në të gjitha rezidenat e tij.

Anëtarët e familjes dëshmojnë që shkrimtarja shkruante në dhomën e ndenjjes dhe ishte mësuar me ndërprerjet që vinin nga mungesa e një dhome pune private. Hapja e derës, që shoqërohej me një gërvishtje, e lajmëronte që dikush po hynte dhe i jepte kohë të fshihte dorëshkrimet, sepse ishte dëshira e saj ta mbante sekret identitetin jo vetëm ndaj publikut të gjerë, por edhe ndaj të njohurve. Vetëm prindërit, vëllezërit dhe e motra kishin dijeni, por të gjithë kishin premtuar ta ruanin sekretin edhe ndaj fëmijëve të tyre. Më vonë, kur romanet e Xhejn Osten kishin përkrahjen e publikut, njëri nga vëllezërit, i ballafaquar me vlerësimet e larta të një konteshe për një nga krijimet e shkrimtares, pohon me krenari, që autorja është vetë e motra. Që nga ky moment sekreti komprometohet njëherë e përgjithmonë. Zakonisht, para çdo botimi, i ati ose e ëma ua lexonin fëmijëve romanet me zë të lartë dhe kishte madje raste që romanet luheshin si pjesë teatrale. Pra, letërsia mbushte darkat e familjes Osten dhe rrethi i ngushtë familjar ishte njëkohësisht edhe rrethi i kritikëve të parë. I ati dhe vëllezërit e vlerësonin kaq shumë punën e saj, sa që janë përpjekur t'i nxirrnin romanet për botim. S'ka dyshim që interesimi dhe mbështetja familjare i ka dhënë krahë veprimtarisë së saj artistike.

Xhejn Osten ka botuar nën pseudonimin - Mrs. Ashton Dennis (M.A.D.) - ose anonimisht - by a Lady - (nga një zonjë). Pseudonimi i zgjedhur me inicialet M.A.D. (angl. *i, e çmendur*) është shenjë e sensit të humorit dhe autoironisë. Pas vdekjes, një prej vëllezërve shkruan - *Kujtimet* - e romancieres. Suksesi i veprave dhe kërkesa e publikut i nxiti kritikët të kërkojnë shkrime të tjera. Kjo përpjekje bëhet shkas për botimin e korrespondencës së Xhejn Osten. Korrespondenca përmban kryesisht letrat të shkëmbyera me të motrën, e cila mbetet shoqja e saj

më e besuar dhe trashëgon edhe veprën e shkrimtares. Kritikët letrarë vazhdojnë të kërkojnë me këmbëngulje të dhëna të reja rreth jetës së prozatores. Por jo vetëm raftet e librarive, por dhe studiot kinematografike janë dëshmitarë të interesit që Xhejn Osten vazhdon të zgjojë; përveç prodhimeve të BBC të - *Krenari e paragjykim* - dhe - *Bindje* - mund të përmenden disa më të reja të romaneve - *Arsye dhe ndjenjë* - me aktoret Kejt Uinslet dhe Ema Tompson, apo - *Ema* - me Guinet Paltrou dhe riprodhimi i fundit i - *Krenari dhe paragjykim* - me Kira Najtli.

Për sa i përket tematikës së veprës, ka kritikë që thonë se qëllimi kryesor i Xhejn Osten është t'i martojë heroinat e saj me burra të mirë e mbi të gjitha të pasur. Megjithatë ky koment nuk është më shumë se një shikim sipërfaqësor, ai shërben si pikënisje në hulumtimin e ideve të Xhejn Osten. Problemet financiare janë një realitet shqetësues për të. Kjo është arsyeja që vepra e saj jep hollësira mbi të ardhurat e personazheve dhe privilegjet apo vështirësitë që gjendja ekonomike sjell me vete. Në këtë pikëpamje ajo ka vlera historike dhe sociale. Nga ana e njohjes së botës njerëzore, romanet e saj paraqesin një shumëllojshmëri personazhesh. Ka nga ata që e administrojnë pasurinë me përgjegjësi, nga ata që e shpërdorojnë dhe nga ata që masin gjithçka me para. Mesazhi është i qartë: paraja kushtëzon marrëdhëniet njerëzore. Por më shumë së çdo gjë tjetër kushtëzon jetën e femrës, fati i së cilës është në qendër të vëmendjes së Xhejn Osten. Në një shoqëri ku meshkujt trashëgojnë pasurinë e familjes, ku vetëm atij i ofrohen mundësi shkollimi dhe integrimi në jetën politike, profesionale e tregtare (mjekët, avokatët e politikanët janë pa përjashtim meshkuj në këtë kohë), gruaja mund t'i shpëtojë skamjes vetëm nëpërmjet martesës. Nëse vepra e Xhejn Osten rrotullohet kryesisht rreth temës së martesës, kjo ndodh

pikërisht për të denoncuar padrejtësinë e të ashtuquajturit treg të martesave (angl. *marriage market*). Shoqëria e saj është shoqëria e parë që funksionon nën ligjet e tregut të lirë dhe një nga gjërat që tregtohet më shumë është gruaja. Kjo është ana pesimiste e veprës së saj. Duke pasur në mendje këtë realitet, pyetja e parë që shkrimtarja shtron është: - Si duhet zgjedhur bashkëshorti, për para apo me dashuri? Ato që duhet ta zgjidhin këtë dilemë, janë mbi të gjitha heroinat e saj, vajza inteligjente, me humor e botë të pasur dhe mbi të gjitha me kërkesa. Vajza që ia njohin vlerën vetes dhe që nuk pranojnë të jenë viktima të kompromiseve monetare, por duan ta ndërtojnë jetën me një bashkëshort që mund të quhet shok. Xhejn Osten nuk është naive dhe nuk tundohet të deklarojë që dashuria mjafton, duke pretenduar që një dashuri e fortë mund t'i përballojë të gjitha, përfshi dhe skamjes. Në këtë kuptim, ajo i reziston nocionit romantik të dashurisë. Por sidoqoftë, ajo nuk i lejon heroinat e saj të bien në pozitat e shoqërisë dhe të shiten tek ai që ofron më shumë, por propozon një rrugë të mesme. Heroinat e saj evitojnë varfërinë ekonomike, por pa sakrifikuar vlerat shpirtërore. Mbi të gjitha ato nuk pranojnë të trajtohen si mall, por përkundrazi me karakterin e tyre bëjnë për vetë lexuesin dhe rrisin dinjitetin e bashkëshorteve.

Xhejn Osten vëzhgon se në shoqërinë angleze të shekullit XVIII martesat janë shndërruar në një kontratë, në një kohë që duhet të jetë bashkimi i dy njerëzve që plotësojnë njëri-tjetrin. Prandaj ajo thotë e sigurtë: - *Nuk më intereson shumë... se ç'mendojnë të rinjtë mbi martesën. Në qoftë së kanë antipati për të, atëherë jam e sigurtë që nuk kanë takuar akoma njeriun e duhur.* Xhejn Osten i qëndron besnike kësaj maksime: romancierja vetë nuk është martuar, por e ka përjetuar sakrificën monetare. Rreth moshës 21-vjeçare dashurohet me një djalë që kalonte pushimet te një teze, fqinjë e shkrimtares.

Lidhja mund të kishte marrë formë serioze, sikur tezja e djaloshit të mos e kishte nisur të nipin në Irlandë, për të evituar një martesë ekonomisht të papërshtatshme. Më vonë i nipi u martua me një vajzë më të kamur se Xhejn Osten. Në moshën 27-vjeçare, moshë kjo kur vajzat konsiderohen nënole, shkrimtarja pranon fillimisht ofertën e një zotërie të pasur, por e refuzon përfundimisht të nesërmen. Supozohet që nuk duhet ta ketë dashur dhe që martesë për para nuk përputhej me aspiratat e saj. Ky fakt është akoma më domethënës për karakterin dhe idealet e novelistes, sepse në shoqërinë e asaj kohe gratë e pamartuara konsideroheshin fatkeqe dhe çfarëdo lloj martesë ishte më e preferuar së sa varësia ekonomike ndaj prindërve apo vëllezërve. Ky vendim do të ketë dhe pasoja të rëndësishme për krijimtarinë e Xhejn Osten, sepse në mungesë të detyrave bashkëshortore, ajo është e lirë t'i dedikohet krejtësisht artit të saj.

\*\*\*

- *Krenari dhe paragjykim* - është shkruar në dy etapa: fillimisht nën titullin - *Përshtypjet e para* - në 1797, por duke qenë se nuk pranohet për botim, del në shtyp 16 vjet më vonë nën titullin e tanishëm, pas disa ndryshimeve të bëra nga vetë autorja. Mund të thuhet se është vepra më e pëlqyer e Xhejn Osten, gjë që kryesisht ka të bëjë me heroinën, Elizabeta Benet. Vetë shkrimtarja ka qenë kaq e kënaqur me këtë heroinë, saqë pas botimit të librit i shkroi së motrës: - E pranoj hapur që më duket se shtypi nuk ka parë krijesë më të mrekullueshme se ajo. Elizabeta Benet të bën për vete me zgjuarsinë dhe humorin e saj të mprehtë. Por edhe partneri i saj i ardhshëm, Darsi nuk mbetet prapa në mençuri dhe zemërgjerësi, pavarësisht se në rastin e tij, këto cilësi nuk zbulohen aq thjesht, sepse ai, në momentet

e para, lë përshtypjen e një personi shumë krenar dhe të paafruar. Aq më tepër që reputacioni i tij rrezikohet nga shpifjet e një zotërie tjetër, Uikamit, i cili është xheloz për pasurinë dhe konsideratën që gëzon Darsi. Elizabeta bie fillimisht në grackën e Uikamit dhe vetëm pas një procesi dëlirjeje kupton thelbin e të dy zotërinjve dhe mbi të gjitha atë të ndjenjave të saj.

Paçka se Elizabeta është në qendër të romanit dhe lexuesi i vëzhgon ngjarjet nga perspektiva e saj, të gjithë personazhet luajnë role të caktuara. Xhejn Osten thekson faktin që jeta e Elizabeta Benetit nuk zhvillohet në vakum, por në gërshtetim me shumë jetë të tjera. Ajo është e përfshirë në një shoqëri që prozatorja i përmbledh me fjalën *fqinjëri*. Kapitulli i parë i romanit e bën lexuesin të ndërgjegjshëm që kur tregohet jeta e një njeriu, nuk mund të harrohet fqinjëria, rrethi i njerëzve që ndikojnë mbi jetën e tij. Ky rreth përbën një mikrokozmos dhe shërben si një pasqyrë e marrëdhënieve njerëzore.

Xhejn Osten ndjek dy qëllime kryesore me analizën e këtij mikro-kozmosi. E para, ajo tregon se si njerëz të shtresave të ndryshme përpiqen të gjejnë një gjuhë të përbashkët në një shoqëri që është në transformim e sipër dhe e dyta, nxjerr në pah padrejtësitë që shoqërojnë jetën e një femre. Gjetja e një gjuhe të përbashkët fillon që në familje si atëherë kur zonja Benet përpriqet të bind të shoqin për t'i vajtur për vizitë Binglit, beqarit të kamur, me shpresë që ta bëjë dhëndër për ndonjë nga vajzat. Beneti nga ana tjetër dëshiron vetëm të mos ia prishin qetësinë me të tilla kërkesa. Beneti gati e detyron Elizabetën të martohet me Kollins për hir të pasurisë, pavarësisht se ky është një mashkull servil dhe i neveritshëm. Elizabeta pretendon nga Darsi që ta trajtojë me dinjitet, paçka se nëna dhe motra e saj e kanë bërë veten për t'u tallur.



Darsi e këshillon Elizabetën në letër, që të mos gjykojë nga paraqitja e jashtme, por të mbështetet te faktet. Uikami përçapet të bëhet i pasur duke marrë për grua motrën e Darsit, në mënyrë klandestine. Darsi pranon të ulet në nivelin e Uikamit për hir të dashurisë dhe e paguan që të martohet me Lidian, motrën e Elizabetës. Lejdi Katerina dhe Bërg nuk le mënyrë pa e ofenduar Elizabetën dhe e urdhëron të mos e pranojë propozimin e të nipit. Këto fërkime mjaftojnë për të ilustruar faktin që aty ku takohen njerëz, ka konflikte dhe që çdo individ përpiket brenda mundësive të pozicionohet në këtë rrjet interesash. Ka nga ata që pozicionohen falë zgjuarsisë apo ndershmërisë, ka nga ata që përdorin çdo mjet. Por një gjë është e qartë: pozicionimi varet nga fuqia ekonomike dhe gjinia.

Të dyja këto pika janë të lidhura direkt me rolin e femrës në shoqëri. Kur femra ka mend, por nuk ka as para as bukuri për të kapur një burrë, shanset e saj për të ngjitur shkallën sociale janë të reduktuara, siç del hapur në rastin e Sharlot Lukasit, mikeshës së Elizabetës. Jeta e Sharlotës do të kishte marrë tjetër rrjedhë, nëse shoqëria ku jetonte i jepte femrave të njëjtat të drejta shkollimi si meshkujve. Ndërkohë që universitetet në fillim të shekullit XIX shkollonin djemtë në fusha nga më të ndryshmet, vajzave iu mësohej të pikturonin me bojëra uji (jo me vaji sepse këto qenë të rezervuara për meshkuj), të qëndisnin, t'i binin pianos, kanto dhe njohuri të përcipta frëngjishteje ose italishteje, sa për të kënduar arie italiane apo franceze. I vetmi profesion që mund të marr Sharlota është ai i guvernantes, profesion ky i paguar dhe i trajtuar aq keq, saqë krahasohej me skllavëri. Pra, oportuniteti më i pranueshëm është martesë dhe duke qenë se Sharlota është 27 vjeç, së shpejti nënole, dhe aspak e bukur, ajo pranon të martohet me Kollinsin. Xhejn Osten futet në

psikologjinë e Sharlotës dhe përshkruan se si ajo duke pasur frikë se mos i shpëton ky rast nga dora, është gati të dëgjojë broçkullat e Kollinsit, në mënyrë që këtij mos t'i shkojë më mendja tek Elizabeta. Sado e sinqertë të jetë shoqëria ndërmjet Sharlotës dhe Elizabetës, instikti i mbijetesës e detyron Sharlotën të tregohet dinake. E vetmja mënyrë se si gruaja mund t'i shpëtojë varësisë ekonomike së prindërve është nënshtrimi ndaj varësisë së bashkëshortit. Sa kohë që rruga e shkollimit është e mbyllur për femrat, pavarësia është utopi. Kjo gjendje është akoma më akute në fillim të shekullit XIX, sepse ndërsa numri i profesioneve shtohet nga dita në ditë dhe ndërmarrja individuale lulëzon si kurrë ndonjëherë, femrat i kanë duart e lidhura.

- *Krenari dhe paragjykim* - vërteton largpamësinë e Xhejn Osten, e cila vëren që ligjet e tregut të lirë do t'ia ndryshojnë njëherë e përgjithmonë faqen shoqërisë. Nëse dikur jeta e individit ishte e programuar që në lindje, në varësi të shtresës, familjes, titujve apo seksit, shoqëria e tregut të lirë do të ofrojë mundësi të reja të panumërta. Jo vetëm ka ardhur koha që femrave t'iu ofrohen të njëjtat mundësi si meshkujve, por dhe që të shpërblehet merita personale. Ky është konflikti kryesor ndërmjet zonjës Katerina, përfaqësuese e aristokracisë së madhe dhe Elizabetës. Për hir të traditës, pasurisë dhe reputacionit të familjes, zonja Katerina i mban shpresat te martesë e të nipit me të bijën, sepse ky ka qenë plani i thurur që kur të dy të rinjtë ishin në djep. Po ashtu ky ishte modeli që ofronte monarkia, sikurse kishin qenë të detyruar të martoheshin Princi Regjent dhe Karolina dhe shumë të tjerë para tyre. Por Xhejn Osten thekson që këtyre principeve iu ka ikur koha. Edhe pse ajo nuk e sulmon direkt monarkinë, ndikimi i Revolucionit Francez bëhet më se i ndjeshëm, kur novelistja ngul këmbë që influenza

e individit nuk përcaktohet nga privilegjet e trashëguara, por duhet fituar, njësoj si e drejta për të udhëhequr një popull, apo në rastin e Elizabetës për të qenë në krye të një familje aq të fuqishme sa familja Darsi.

Xhejn Osten është partizane e një shoqërie që shpërblen meritën dhe jo prejardhjen. Kjo nuk do të thotë që ajo propagandon rrëzimin e monarkisë, hedhjen poshtë të traditës kulturore apo rrënimin e familjeve aristokrate. Zgjidhja e saj është e balancuar dhe ilustron fare mirë në fund të romanit - *Krenari dhe paragjykim*. Martesa e Darsit dhe Elizabetës mishëron bashkimin e privilegjeve të trashëguara me meritën e fituar, ndërthurjen e klasës aristokratike me atë të mesme, e detyrimeve familjare me lumturinë personale.

\*\*\*

Xhejn Osten, si shumë gra të tjera të shtresës së mesme, nuk pati ndonjë shkollim që mund t'i kishte dhënë të drejtë të ushtronte një profesion. Jeta e saj është shtjelluar në mes të njerëzve më të afërt, me shoqërinë dhe vizitat e të njohurve dhe fafesisit. Por në qetësi dhe anonimitet, ajo ka qenë shkrimtare. Ajo jo vetëm shkroi rreth pavarësisë dhe të drejtave të gruas, por edhe arriti njëfarë pavarësie brenda mundësive që iu dhanë. Paçka se nuk përfitoi ekonomikisht frytet e punës së saj, si shumë shkrimtare të tjera, ajo ka investuar me zotësi të rrallë dhe mendim të pavarur në atë që konsideronte profesionin e saj, letërsinë. Veprimtaria artistike e Xhejn Osten ka frymëzuar në të kaluarën (siç shkruajnë më pas mbesa dhe i nipë) dhe vazhdon të frymëzojë brezin e ri që ta ushtrojë krijimin letrar në gjurmët e saj.

ENIT STEINER - KARAFILI

Titujt aristokratikë në Anglinë e shekullit XVIII	
Dukë	Dukeshë
Markez**	Markezë
Kont**	Konteshë
Vikont**	Lejdi
Baron**	Baroneshë* ose Lejdi
Baronët	Lejdi
Sër (Kalorës)	Damë* ose Lejdi

---

\*Baroneshë dhe damë i takojnë vetëm femrave që e kanë trashëguar titullin, ndërsa bashkëshortja e baronit apo e Sër-it mban titullin Lejdi.

\*\* Personat që mbajnë këto tituj mund të adresohen edhe me titullin Lord, pra dikush që është Lord mban një prej këtyre titujve.

# Libri i parë

## Kapitulli një

Është një fakt i njohur në të gjithë universin, që një beqari të kamur i nevojitet një bashkëshorte. Sadopak të njohura të jenë ndjenjat dhe mendimet e një personi të tillë, kur vjen për herë të parë në fqinjëri, ky fakt është i ngulur kaq mirë në mendjet e fqinjëve, sa që ata e konsiderojnë pronë të ligjshme për ndonjë nga vajzat e tyre.

- I dashur z. Benet<sup>1</sup>, - i tha e shoqja një ditë, - e ke marrë vesh që më në fund Parku i Nedhërfildit është dhënë me qira?

Z. Benet u përgjigj që jo.

- Po, është dhënë, - ia ktheu ajo, - znj. Long sapo ishte këtu dhe më vuri në dijeni rreth gjithçkaje.

Z. Benet nuk foli.

- Nuk të intereson të dish se kush e ka marrë? - thërriti e shoqja me padurim.

- *Ti* do të ma thuash dhe unë s'jam kundër ta dëgjoj.

Kjo përgjigje qe një ftesë e mjaftueshme.

- Duhet ta dish, i dashur, që znj. Long thotë që Nedhërfildin e ka marrë një djalosh i pasur nga veriu

---

<sup>1</sup> Paçka se znj. Benet i drejtohet të shoqit, ajo nuk e thërret në emër, sepse në fillim të shekullit XIX marrëdhëniet në familje janë tepër formale për hir të ruajtjes së hierarkisë.

i Anglisë, i cili ka ardhur për ta parë të hënën me një kaloshinë të tërhequr prej katër kuajsh<sup>1</sup> dhe ka mbetur kaq i kënaqur, saqë ra dakord menjëherë me z. Moris. Ka për të hyrë në Nedhërfild para ditës së Shën Mihalit<sup>2</sup>. Një pjesë e shërbëtorëve të tij do të futen në shtëpi nga fundi i javës.

- Si e ka emrin?

- Bingli.

- Është i martuar apo beqar?

- Ah! Sigurisht beqar, i dashuri im! Beqar e me gjithë atë pasuri: katër ose pesë mijë stërlinga në vit<sup>3</sup>. Do ishte shkëlqyeshëm për vajzat tona!

- Pse? Ç'hyjnë ato?

- I dashur z. Benet, - ia ktheu e shoqja, - sa i lodhshëm që je nganjëherë! Duhet të ta marrë mendja vetë që dua që ai të martohet me një nga vajzat tona.

- Ka ndër mend të ngulet këtu ai?

- Ndër mend! Gjepura, si flet kështu! Por ka shumë *mundësi* të bjerë në dashuri me njërën prej tyre dhe kjo është arsyeja që duhet t'i shkosh për vizitë sapo të mbërrijë<sup>4</sup>.

- Nuk shoh asnjë arsye për të shkuar. Ti mund të shkosh me vajzat, ose më mirë akoma dërgoju vetëm, sepse ti je po aq simpatike dhe mund t'i pëlqesh z. Bingli më shumë se të gjitha ato.

- I dashur, po më lajkaton. Sigurisht që në kohën time kam qenë simpatike, por nuk pretendoj të jem ndonjë

---

<sup>1</sup> Kaloshina me katër kuaj është tregues për pasurinë e z. Bingli.

<sup>2</sup> Dita e Shën Mihalit festohet në 29 Shtator dhe shënon fillimin e vjeshtës, shkurtimin e ditëve dhe zgjatjen e netëve.

<sup>3</sup> Në këtë periudhë 1 stërlingë vlenë 33 dollarë amerikanë të sotëm, çka do të thotë që z. Bingli ka të ardhura vjetore prej 130.000 -165.000 mijë dollarë amerikanë në vit.

<sup>4</sup> Burri i shtëpisë është kryesisht ai që vendos marrëdhëniet. Znj. Beneti, duke qenë gua nuk mund të prezantohet pa ndërmyjetësinë e të shoqit.

bukuri e rrallë tani. Nëna që ka pesë vajza të rritura, duhet të heqë dorë nga bukuria e saj.

- Në raste të tilla gruaja shpesh nuk ka ndonjë bukuri për të hequr dorë.

- Sidoqoftë, i dashur, duhet të shkosh ta takosh patjetër z. Bingli kur të vijë këtu.

- Të siguroj, që nuk e marr përsipër.

- Për hir të vajzave! Mendo sa mirë mund ta rregullonim njëren prej tyre. Sër Ulliam Lukas dhe lejdi Lukas<sup>1</sup> kanë vendosur të shkojnë, vetëm për këtë arsye, sepse ti e di që zakonisht ata nuk i vizitojnë fqinjët e rinj. Duhet të shkosh patjetër, sepse do jetë e pamundur për *ne* t'i shkojmë për vizitë, pa i vajtur ti.

- S'ka dyshim që je më e ndërgjegjshme se sa duhet. Them se z. Bingli do t'i bëhet qejfi kur t'ju shohë dhe unë do t'i shkruaj disa rreshta, ku miratoj me gjithë zemër martesën e tij me atë vajzë që do zgjedhë, megjithëse duhet të futem mik për Lizin.

- S'dua të bësh një gjë të tillë. Lizi s'ka asgjë më shumë se të tjerat dhe jam e sigurtë që nuk ka as gjysmën e bukurisë së Xhejnit, as gjysmën e çiltërsisë së Lidias. Por ti *atë* e mban gjithmonë me hatër.

- Asnjëra nuk ka vlera të veçanta, - ia ktheu ai, - të gjitha janë budallaçka dhe injorante si vajzat e tjera, por Lizi është diçka më e mprehtë se të motrat.

- Z. Benet, si flet kaq keq për fëmijët e tu? Qejfi yt është të më nxehësh mua. S'të vjen keq për të shkretat nervat e mia.

- E ke gabim, e dashura ime. Unë kam respekt të madh për nervat e tua. I kam shokë të vjetër. Të kam dëgjuar t'i

---

<sup>1</sup> Sër dhe Lejdi janë tituj anglezë, prandaj nuk mund të përkthehen me z. ose znj. Këta tituj trashëgoohen ose blihen, si në rastin e sër Ulliam Lukas. Blerja e titullit praktikohet edhe sot e kësaj dite në Angli. Rastet më të famshme të ditëve të sotme janë dy këngëtarët, sër Elton Xhon dhe sër Pol Mak Cartni.

përmendësh me respekt të paktën këto njëzet vitet e fundit.

- Ah, ti s'e di se ç'vuaj unë!

- Por shpresoj që do ta marrësh veten, do të rrosh e do shohësh shumë djem me katër-pesë mijë sterlinga në vit në fqinjëri.

- Edhe sikur njëzet të vijnë, s'kanë për të më hyrë fare në punë, sa kohë që ti nuk iu shkon për vizitë.

- Të jesh e sigurtë, e dashur, që kur të bëhen njëzet, do t'iu shkoj të gjithëve.

Z. Benet që i gatuar në mënyrë kaq të çuditshme - një përzierje mprehtësie, sarkazmi, rezervimi dhe kapriçoje - saqë së shoqes nuk i kishte mjaftuar përvoja 23-vjeçare për t'ia kuptuar tipin. Ndërsa tipi i saj zbulohet më lehtë. Ajo kishte pak mend, pak dije dhe një natyrë të ndryshueshme. Kur ishte qejfprishur, e quante veten nervoze. Qëllimi i jetës së saj ishte të martonte të bijat, ngushëllimi ishin vizitat dhe thashethemet.



## Kapitulli dy

**Z**. Benet ishte ndër të parët që takuan z. Bingli. Gjatë gjithë kohës e kishte pasur në mendje ta takonte, edhe pse deri në momentin e fundit vazhdonte ta kundërshtonte të shoqen, e cila nuk kishte dijeni deri në mbrëmjen e ditës kur z. Benet e kishte kryer vizitën. Në mbrëmje e vërteta u mor vesh si vijon. Kur pa të bijën duke zbukuruar një kapele, ai iu drejtua asaj papritur:

- Uroj që t'i pëlqej z. Bingli, Lizi.

- Nga ta njohim ne shijen e z. Bingli, - tha e ëma gjithë mllef, - ne nuk i shkojmë për vizitë.

- Po harrove mama, - tha Elizabeta, - që do ta takojmë në ballo dhe znj. Long premtoi të na e prezantojë.

- S'më besohet që do të na prezantojë. Znj. Long ka vetë dy mbesa, është një grua egoiste dhe e shtirur, për të cilën nuk kam konsideratë.

- As unë, - tha z. Beneti, - dhe jam i gëzuar që nuk ke nevojë për shërbimin e saj.

Znj. Benet nuk denjoi të replikonte, por duke mos e mbajtur dot veten iu kthye me inat njëres prej së bijave.

- Boll u kollite, Kiti, për hir të perëndisë. Ki pak mëshirë për nervat e mia. M'i bëre copë.

- Kiti nuk ka fare kujdes me kollën, - tha i ati, - kollitet me kohë e pakohë.

- Pse qejf kam unë të kollitem? - u hakërrua Kiti.

- Kur e ke ballon Lizi?

- Nesër dy javë.

- A, kështu qenka puna, - klithi e ëma, - znj. Long vjen një ditë para ballos dhe nuk ka se si të na prezantojë, sepse s'e njeh për vete.

- Atëhere, e dashura ime, do jesh ti ajo që do e marrë përsipër prezantimin e z. Bingli.

- E pamundur, z. Benet, e pamundur. Unë s'jam prezantuar për vete. Sa acarues që bëhesh.

- Maturia jote është për t'i hequr kapelën. Ç'është e vërteta dy javë njohje janë shumë pak. Ku i dihet se si ndryshojnë njerëzit në krye të dy javëve. Por po s'e morëm ne guximin, do ta bëj dikush tjetër. Në fund të fundit i duhet dhënë shansi edhe znj. Long e të mbesave. Ajo do ta vlerësojë mirësjelljen tonë, prandaj po e refuzove ti prezantimin, atëherë do e bëj unë.

Vajzat i ngulën sytë të atit. Znj. Benet tha vetëm: - Gjepura, gjepura!-

- Si ta kuptojë këtë britmë të theksuar, - thirri ai. - I konsideron gjepura rregullat dhe rëndësinë që i jepet prezantimit? Nuk jam dakord me ty. Si thua ti Meri? Sepse e di që ti je një zonjushë e thellë që lexon libra te mëdhenj dhe mban shënime.

Meri donte të thoshte diçka të mençur por s'po dinte se si.

- Sa kohë që Meri rendit idetë, - vazhdoi ai, - le të kthehem te z. Bingli.

- Më ka ardhur në majë të hundës z. Bingli, - ia priti e shoqja.

- Për këtë më vjen keq, po pse nuk ma the më përpara? Ta kisha ditur në mëngjes, nuk kisha për ta takuar. Për fat të keq tani që unë i kam shkuar për vizitë nuk i shpëtojmë dot njohjes me të.

Ai donte të nxiste habinë e grave dhe ia arriti qëllimit. Habia e znj. Benet e kalonte atë të të bijave, megjithëse pasi rrëmuja e gëzimit kishte kaluar, ajo filloi të deklaronte që ia kishte ndjerë zemra gjatë gjithë kohës.

- Sa i mirë që je treguar, i dashuri im, z. Benet! Por e dija që do të të bindja më në fund. Isha e sigurtë që dashuria që ke për vajzat e tua s'do të linte të neglizhoje një rast të tillë. Sa ma ke bërë qejfin! Dhe është alamet shakaje që ke vajtur sot në mëngjes pa thënë asnjë gjysmë fjale.

- Kiti tani mund të kollitesh sa të duash, - tha z. Benet duke dalë nga dhoma, i lodhur nga ngazëllimi i së shoqes.

- Ç'baba të mirë që keni moj vajza, - tha ajo kur u mbyll dera. - Nuk e di si do t'ia shpërbleni mirësinë atij, ose mua ç'është e drejta. Sa për dijeni, në moshën tonë nuk është e këndshme të bësh njohje të reja, por ne jemi gati të bëjmë gjithçka për ju. Lidia, shpirt, edhe pse je më e vogla, them se z. Bingli do të vallëzoj me ty në ballo.

- Of! - tha Lidia e vendosur, - nuk kam frikë. Paçka se më e vogla, jam më e gjata.

Gjithë mbrëmjen e kaluan duke hamendësuar se kur do t'ua kthente vizitën z. Bingli dhe kur duhet ta ftonin për drekë.

## Kapitulli tre

Sado pyetje që znj. Benet, i bëri të shoqit rreth z. Bingli dhe me gjithë ndihmën e pesë të bijave, nuk arriti të nxjerrë ndonjë informacion të kënaqshëm prej tij. Megjithëse ato nuk lanë gjë pa provuar, duke e sulmuar me pyetje të hapura, me hamendje naive dhe me të hedhura larg e larg, ai diti t'i shmangej kërkesave të tyre. Në fund fare ato ishin të detyruara të pranonin informacione nga goja e fqinjës, lejdit Lukasi. Përshkrimi i kësaj ishte shumë pozitiv. Sër Ulliami kishte mbetur i mrekulluar me djaloshin. Ai ishte goxha i ri, shumë i pashëm dhe jashtëzakonisht i këndshëm. Ky përshkrim u kurorëzua me lajmin që djaloshi kishte në plan të vinte në ballo i shoqëruar prej disa të tjerëve. S'kishte gjë më fantastike! Dëshira për të vallëzuar ishte afër të rënës në dashuri, gjë që atyre ua rriti shpresat për të fituar zemrën e z. Bingli.

- Ah sikur të rroja të shihja njëri-njëri prej vajzave të rregulluar në Nedherfeld, - i tha znj. Benet të shoqit, - edhe të tjerat të rregulluara mirë dhe s'do doja gjë tjetër.

Disa ditë më pas z. Bingli ia ktheu vizitën z. Benet dhe kaloi rreth dhjetë minuta në dhomën e punës së tij. Ai kishte patur shpresë t'i hidhte një sy vajzave, bukurinë e të cilave ia kishin mburrur shumë, por takoi vetëm të atin. Femrat qenë më me fat, sepse patën avantazhin të shihnin

nga dritarja që djaloshi ishte veshur me një pallto blu dhe kalëronte mbi një kalë të zi.

Atëherë atij iu dërgua menjëherë një ftesë për drekë, por kur znj. Benet kishte planifikuar të gjitha gatimet që do ta nderonin si amvisë, arriti një lajm që i shtyu këto plane. Z. Bingli ishte i detyruar të shkonte në qytet të nesërmen dhe e kishte të pamundur të pranonte nderin që po i bëhej. Znj. Benet ishte tërësisht e dekurajuar. Ajo s'e imagjinonte dot se ç'punë mund t'i kishte dalë në qytet kaq pak kohë pas mbërritjes së tij në Hertfordshër<sup>1</sup>, saqë filloi t'i hipte frika që ai e kishte zakon të hidhej nga një vend në tjetrin dhe s'do të ngulej kurrë në Nedhërfild. Lejdi Lukas e qetësoi disi duke i thënë se kishte shkuar në Londër vetëm për të sjellë disa persona të tjerë në Nedhërfild. Më pas thuhej se z. Bingli do të sillte dymbëdhjetë zonjusha dhe shtatë djem të rinj në ballo. Vajzat u pikëlluan kur dëgjuan numrin e zonjushave, por u ripërtërinë kur morën vesh që kishte sjellë vetëm gjashtë persona nga Londra, pesë motra dhe një kushëri. Madje kur hynë në sallën e vallëzimit ata ishin vetëm vetë i pestë: z. Bingli me dy motra, të shoqin e motrës së madhe dhe një djalosh tjetër.

Z. Bingli ishte i pashëm dhe dukej zotëri, me një fytyrë të këndshme dhe një sjellje të thjeshtë e të çiltër. Të motrat ishin elegante dhe moderne. Kunati, z. Hërst, ishte një zotëri normal, por shoku i tij, z. Darsi, s'vonoit t'iu binte në sy të gjithëve. Ai ishte trupgjatë, elegant, me tipare tërheqëse fisniku dhe siç pëshpëritej vetëm pesë minuta pas ardhjes së tij, ishte me dhjetë mijë paund në vit.<sup>2</sup> Zotërinjtë vlerësuan figurën e tij elegante, zonjushat e quajtën më të pashëm se z. Bingli dhe të

---

<sup>1</sup> Krahinë në jug të Anglisë.

<sup>2</sup> Me këtë pasuri Darsi bën pjesë në 400 familjet më të pasura të kësaj periudhe.

gjithë e vështronin me admirim gjatë pjesës së parë të mbrëmjes, deri kur sjellja e tij i indinjoi dhe i dha fund popullaritetit, sepse u kuptua që ishte krenar, megaloman dhe që zor kënaqej. Që nga ai moment, as pronat e tij në Darbishër nuk e shpëtonin dot më; ai kishte një fytyrë të frikshme, të vrenjtur dhe ishte i padenjë të krahasohej me shokun e tij.

Z. Bingli shumë shpejt ishte prezantuar me shumicën e njerëzve në sallë; ai ishte i qeshur, i afruar dhe s'la vallëzim pa u çuar, saqë u mërzi kur balloja mbaroi aq herët dhe deklaroi që do të jepte vetë një në Nedhërfild. Të tilla cilësi nuk kishin nevojë për reklamë! Çfarë kontrasti ndërmjet dy shokëve! Z. Darsi kërceu vetëm njëherë me znj. Hërst dhe njëherë me znj. Bingli; nuk pranoi të prezantohej me ndonjë zonjushë tjetër dhe e kaloi mbrëmjen duke u sjellë nëpër sallë dhe duke folur tek-tuk me miqtë e tij. Nuk kishte më asnjë dyshim mbi karakterin të tij: Burrë më mendjemadh dhe më të papëlqyeshëm se ai nuk kishte në botë! Të gjithë uronin të mos ta shihnin më. Znj. Benet ishte ndër kundërshtarët e tij më të flakta. Antipatia që ndjente fillimisht për të ishte shndërruar në fyerje, që kurse z. Darsi s'ia kishte varur njërës prej të bijave.

Elizabetha që e detyruar të rrinte ulur gjatë dy vallëzimeve, sepse kishte më pak meshkuj se vajza. Ndërkohë i kap veshi një bisedë ndërmjet z. Darsi, i cili qëndronte në këmbë aty afër dhe z. Bingli, i cili e kishte lënë vallëzimin për ta inkurajuar shokun të çohëj.

- Eja, Darsi, - tha ai, - dua të kërcesh. S'e duroj dot kur rri në këmbë si torollak. Kërce më mirë.

- Në asnjë mënyrë! Ti e di se sa inat kam kur nuk e njoh partneren. Në një ballo të tillë është e padurueshme. Motrat e tua janë të zëna dhe me femrat e tjera kërcimi do ishte ndëshkim.

- Kot tregohesh kaq nazeli, - klithi Bingli, - për nder, s'kam takuar ndonjëherë kaq shumë vajza të këndshme si në këtë mbrëmje. Spikas disa simpatike.

- E vetmja simpatike që spikas unë është partnerja jote, - tha z. Darsi duke vështruar vajzën e madhe të Benetëve.

- Ah po! Është krijesa më e bukur që kam parë! Po ngjitur prapa teje është ulur një nga motrat e saj, e cila më duket simpatike dhe shumë e lezetshme. Lërmë ta pyes partneren time të ta prezantojë.

- Për cilën e ke fjalën, - dhe duke kthyer kokën, i nguli sytë Elizabetës. Kur kapi vështrimin e saj i hoqi sytë dhe tha ftohtë: - Çka, është e pranueshme, por jo aq e pashme sa për të më joshur mua dhe s'kam humor t'ua var vajzave që nuk ia varin të tjerët. Ktheu te partnerja jote, gëzoju buzëqeshjeve të saj e mos humb kohën me mua.

Z. Bingli e ndoqi këtë këshillë. Z. Darsi u largua dhe Elizabeta mbeti vetëm, me mbresa jo shumë të përzemërta. Megjithatë ajo ua tregoi shoqeve të saj ndodhinë, sepse me tipin e gjallë dhe natyrën lozonjare që kishte, i pëlqente të vinte në lojë gjithçka qesharake.

Mbrëmja kaloi në përgjithësi mirë për të gjithë familjen. Znj. Benet i kishte rënë në sy që miqtë e Nedhërfildit kishin mbetur të mahnitur me vajzën e madhe. Z. Bingli e kishte marrë dy herë për vallëzim dhe të motrat e kishin trajtuar ndryshe nga të tjerat. Kjo i kishte dhënë edhe Xhejnit kënaqësi, ndonëse ajo e përjetonte më qetë se e ëma. Elizabetës i vinte mirë për Xhejnin. Meri kishte dëgjuar dikë ta citonte para znj. Bingli si vajzën më të kompletuar të fqinjërisë. Katerina<sup>1</sup> dhe Lidia kishin pasur fatin të mos mbeteshin asnjë moment pa partnerë, gjë që për to qe më e rëndësishmja në ballo. Kështu që të gjithë

---

<sup>1</sup> Katerina është vajza e parafundit e familjes, të cilën e thërrasin shkurt Kiti.

ishin në qejf kur u kthyen në Longborn, në fshatin ku jetonin dhe ishin banorët kryesorë. Z. Benet e gjetën zgjuar, ai e humbiste sensin e kohës duke lexuar dhe pas një nate të tillë, kishte goxha kuriozitet rreth mbrëmjes që kishte zgjuar aq shpresa të mëdha. Ai kishte shpresuar që e shoqja do të kishte mbetur e zhgënjyer prej jabanxhiut, por e kapi shpejt që duhet të përgatitej për të kundërtën.

- Ah, i dashuri im, z. Benet, - tha e shoqja duke u futur në dhomë, - kemi kaluar një mbrëmje shumë të këndshme dhe një ballo te shkëlqyer. Ah sikur të kishe qenë dhe ti. Xhejnin e kanë admiruar sa më s'bëhet. S'pati njeri mos të thoshte sa mirë dukej. Z. Bingli iu duk goxha e bukur dhe e ftoi dy herë në vallëzim. Ta merr mendja i dashur, ai vallëzoi dy herë me të dhe ishte e vetmja që mori dy herë. Të parën fare mori znj. Lukas. Kur e pashë të ngrihej me të, unë u nxeha, por ai nuk është se e pëlqeu. Në fakt asnjë nuk e pëlqen atë vajzë. Kur pa Xhejnin në pistën e vallëzimit, mbeti i habitur. Atëherë kërkoi të dinte emrin e saj dhe ta prezantonin me të. E mori për dy vallëzime njëri pas tjetrit. Pastaj për vallëzimin e tretë mori znj. King, për të katërtin Maria Lukasin dhe për të pestin prapë Xhejnin dhe të gjashtin Lizin dhe bulonzherën<sup>1</sup>...

- Po t'i kishte ardhur keq për mua, - ia briti i shoqi me padurim, - s'do kishte kërcyer as gjysmën e vallëzimeve që kërceu! Në ke Zot, mos më lodh më me partneret e tij. Ah, nga s'e theu këmbën që në vallëzimin e parë!

- Ah, i dashur, - vazhdoi znj. Benet, - mbeta shumë e kënaqur prej tij; është shumë i pashëm dhe të motrat duken

---

<sup>1</sup> Znj. Benet e ka fjalën për një vallëzim francez shumë të përhapur në Angli, që kërcëhej në fund të ballos dhe ku partnerët formonin dy rreshta të gjatë, por z. Benet nuk ka më durim ta dëgjojë dhe e ndërpret.



goxha zonja. S'më kanë parë sytë fustane aq elegante si të tyre. Po të them, që gajtani i fustanit të znj. Hërst...

S'e mbaroi dot fjalën, sepse i shoqi e ndërpreu duke protestuar ndaj përshkrimeve të stolirave. Ajo ishte e detyruar të merrte një drejtim tjetër dhe i raportoi me hidhërim dhe ekzagjerim sjelljen e keqe të z. Darsi.

- Por të siguroj unë, Lizit as i prishet puna fare se nuk e pëlqeu z. Darsi, sepse ai është një kryeneç që s'durohet dot. Shkonte e vinte, me një krenari sikur ç'i dukej vetja! S'qenka aq e pashme sa për të vallëzuar me të! Ah, të kishe qenë atje, i dashur, t'ia kishe treguar vendin ashtu si di ti. E urrej atë person.

## Kapitulli katër

**K**ur Xhejni dhe Elizabeta mbetën vetëm, Xhejni që deri në atë moment kishte qenë më e rezervuar me lavdërimet z. Binglit, i shprehu së motrës konsideratën e madhe që kishte për të.

- Është një djalë model, - tha ajo, - i ndjeshëm, me humor e i çiltër. S'kam njohur njeri me sjellje kaq të gëzuar, aq të thjeshtë dhe aq të edukuar.

- Pa le që është edhe i pashëm, - ia ktheu Elizabeta, - gjë që një djalë model duhet ta ketë, po të jetë e mundur. Kështu që karakteri i tij është i kompletuar.

- M'u bë qejfi shumë që më kërkoi dy herë në vallëzim. Nuk e prisja një kompliment të tillë.

- Nuk e prisje? Unë e prisja për ty. Në këtë pikë ne jemi krejt ndryshe. Ti s'i pret asnjëherë komplimentet, kurse unë po. Kishte gjë më të natyrshme se sa të kërkonte përsëri? Po dhe ai pa mirë që bukuria jote ia kalonte nja pesë herë çdo femre tjetër në atë sallë. Këtu s'ka vend për t'i qenë mirënjohëse sjelljes së tij galante. Patjetër, ai është shumë i këndshëm dhe ke të drejtë ta pëlqesh. Të kanë pëlqyer edhe më budallenj se ai.

- Moj Lizi!

- Ti ke tendencë t'i pëlqesh të gjithë njerëzit. Nuk sheh defekte tek asnjëri. Të duken të gjithë të mirë e të këndshëm. S'të kam dëgjuar njëherë të kritikosh dikë.

- Nuk dua të nxitohem kur kritikoj dikë, por për të thënë, them gjithmonë atë që mendoj.

- Këtë e di dhe është pikërisht kjo që më çudit. Si ka mundësi të jesh aq e mençur dhe sinqerisht aq e verbër ndaj marrëzive të të tjerëve? Të ketë mirësi aty ky ka dashuri është normale dhe e shprehur. Por të tregosh mirësi aty ku s'ke interes, t'iu marrësh njerëzve të mirat dhe t'ua rritësh vlerat edhe më shumë e të mos flasësh keq për njeri, këtë e bën vetëm ti. Po mirë, po të pëlqejnë edhe motrat e djaloshit, apo jo? Ato duken ndryshe nga ai.

- Sigurisht, për momentin e parë. Por janë të dashura kur futesh në bisedë. Znj. Bingli do të jetojë me të vëllain, do drejtojë shtëpinë e tij dhe qofsha e gabuar, por nuk doli fqinjë e këndshme.

Elizabeta dëgjonte në heshtje, por nuk qe e bindur që sjellja që kishte parë në ballo të ishte qëllimisht e këndshme. Duke qenë tip më i mprehtë, jo aq e epur sa e motra dhe e painfluencuar në gykimin e saj, ajo nuk i fuste dot në zemër motrat e Binglit. Në fakt ato dukeshin alamet zonjash<sup>1</sup>, kur donin me goxha humor dhe aspak të paafta për të qenë të këndshme kur iu vinte mbarë, por ishin krenare dhe mendjemëdha. Ishin goxha simpatike, kishin shkuar në një nga shkollat<sup>2</sup> private më të mira të qytetit dhe duke pasur njëzet mijë stërilinga<sup>3</sup>, shpenzonin zakonisht më shumë se sa duhej dhe shoqëroheshin

---

<sup>1</sup> Ky epitete ka të bëjë më shumë me pasurinë e motrave Bingli se sa me karakterin. Veshja dhe sjellja e tyre përforcojnë këtë aspekt.

<sup>2</sup> Jo vetëm shkollat, por edhe programet shkollore në shekullin XVIII ishin të ndara sipas seksit. Femrave iu mësohej anglisht, pak frëngjisht, rrallë histori dhe gjeografi, shkrim, vizatim, vallëzim dhe muzikë. Djemtë mësonin gjuhët klasike, latinisht dhe greqisht, letërsi dhe shkencat e sakta. Akoma nuk ekzistojnë shkollat shtetërore, prandaj shkollimi varet nga fuqia ekonomike.

<sup>3</sup> Trashëgimia e motrave Bingli është njëzet fishi i motrave Benet.

vetëm me njerëz të pasur. Si rrjedhojë, ishin në një pozitë që i lejonte të kishin mendim të mirë për veten e tyre dhe të keq për të tjerët. Vinin nga një familje e respektuar e Anglisë Veriore, gjë që e kujtonin më shpesh se faktin që pasuria e familjes së tyre ishte fituar me tregti.<sup>1</sup>

Z. Bingli kishte trashëguar gati njëqind mijë paund<sup>2</sup> prej të atit, i cili po të kishte rrojtur, do të kishte blerë një pronë. Z. Bingli e kishte patur qëllim dhe mendonte herë pas here të blinte diçka në vendlindjen e tij. Por qëkurse kishte gjetur një shtëpi të mirë<sup>3</sup> që i jepte shumë liri, ata që ia njihni thjeshtësinë, besonin që ai do ta kalonte jetën në Nedhërfild dhe do t'ia linte blerjen e pronave brezit tjetër.

Të motrat mezi prisnin të blinte një pronë. Por, megjithëse për momentin i vëllai ishte vetëm qiramarrës në Nedhërfild, znj. Bingli i vinte mbarë të ulej në krye të tavolinës, kurse znj. Hërst ta konsideronte shtëpinë e tij si të sajën, sa herë t'ia donte puna, sepse ajo kishte marrë një burrë më shumë elegant se sa pasanik. Vetëm dy vjet pasi z. Bingli ishte bërë madhor, një rekomandim i rastësishëm e kishte tërhequr drejt shtëpisë së Nedhërfildit. Brenda një gjysmë ore, ai i kishte hedhur një sy jashtë e brenda, kishte mbetur i kënaqur me gjendjen e përgjithshme dhe me dhomat. I kënaqur dhe me lavdërimet e pronarit, ai e kishte marrë pa një pa dy.

---

<sup>1</sup> Kjo e dhënë tregon që familja Bingli nuk ka gjak aristokrat dhe pasuria e tyre nuk është trashëgim i një familjeje shumëvjeçare fisnike, por e fituar në tregti. Klasa aristokratike në përgjithësi kishte neveri për atë tregtare.

<sup>2</sup> Pra Bingli ka rreth 3.300.000 stërlinga, plus të ardhurat vjetore 160.000.

<sup>3</sup> Fjala bëhet për vila të mëdha, me toka dhe pyje rreth e rrotull, në të cilat pronari apo qiramarrësi kishte të drejtë të ushtronte edhe gjuetinë, një hobi shumë e përhapur në këtë periudhë.

Me Darsin e lidhte një shoqëri e qëndrueshme, pavarësisht se karakteret e tyre kontrastonin. Darsi pëlqente te Bingli thjeshtësinë, çiltërsinë dhe butësinë, në një kohë që këto cilësi ishin krejt të kundërta nga vetvetja, me të cilën Darsi s'dukej kurrë i pakënaqur. Bingli kishte një siguri të patundur në mirëdashjen e Darsit dhe vlerësimin më të lartë për mendimin e tij. Sa për intelekt Darsi ia kalonte. Bingli nuk ishte në asnjë mënyrë i mangët, por Darsi ishte i zgjuar. Por ishte edhe kryeneç, i rezervuar e nazeli dhe sjellja e tij, edhe pse e edukuar, nuk të afronte. Në këtë pikë shoku i tij shkëlqente. Bingli ishte i sigurtë që pëlqehet ngado që të vinte, kurse Darsi i ofendonte të tjerët vazhdimisht.

Mënyra se si u fol rreth ballos në Meriton ishte boll tipike. Bingli s'kishte takuar në botë njerëz aq të këndshëm e vajza aq të pashme. Të gjithë e kishin trajtuar me njerëzillëkun më të madh, pa formalitet, pa ftohtësi dhe brenda pak kohësh ai ishte njohur me të gjithë sallën. Sa për znj. Benet, atij nuk i kishin parë sy engjëlli më të bukur. Darsi, përkundrazi, kishte ndeshur një sërë njerëzish pak të pashëm dhe pak elegantë. Asnjë prej të pranishmëve nuk i kishte zgjuar as interesin më të vogël dhe s'i kishte falur vëmendje apo kënaqësi. Pranoi që znj. Benet ishte simpatike, veçse buzëqeshte më shumë nga ç'duhej.

Znj. Hërst dhe e motra i dhanë të drejtë në këtë pikë, por sidoqoftë e pëlqyen dhe e çmuan si një vajzë të dashur, që donin ta njihnin më mirë. Atëherë u vendos që znj. Benet ishte një vajzë e ëmbël, gjë që i dha autorizim të vëllait të mendonte ç'të donte rreth saj.

## Kapitulli pesë

Vetëm pak hapa më tutje banonte një familje me të cilën Benetët bëheshin shumë. Sër Uilliam Lukas ishte marrë më parë me tregti në Meriton, ku kishte vënë një pasuri të konsiderueshme dhe, pasi i kishte bërë kërkesë mbretit, gjatë prefekturës ishte ngjitur në rangjet e larta të kalorësisë. Ky ndryshim ishte përjetuar ndoshta më fortë se ç'duhej, sepse ia kishte neveritur biznesin dhe rezidencën që kishte në një qytet tregtar. Me të hequr dorë prej të dyjave, ai ishte zhvendosur në një shtëpi një milje larg Meritonit, që e kishte emërtuar Lukas Loxh, ku mund të mendonte me kënaqësi rreth rëndësisë së tij dhe i çliruar nga biznesi mund t'i dedikohej plotësisht rregullave të mirësjelljes. Rritja e rangut nuk e kishte bërë fodull, por përkundrazi më të vëmendshëm ndaj kujdo. Me tipin jo fyes, të dashur dhe të respektueshëm që kishte, prezantimi në Shën Xhejms<sup>1</sup> e kishte bërë xhentil.<sup>2</sup>

Lejdi Lukas ishte grua e mirë, jo aq e zgjuar sa znj. Benet që ta çmonte si fqinjë. Ata kishin disa fëmijë. Vajza e parë, një vajzë e mençur, rreth të njëzeteshtatave, ishte shoqja e ngushtë e Elizabetës.

---

<sup>1</sup> Pallati mbretëror ku jepet titulli.

<sup>2</sup> Fjala - xhentil - nuk tregon vetëm cilësi të karakterit, por mbi të gjitha rangun.

Që zonjushat Lukas dhe Benet duhet të takoheshin për të komentuar ballon, kjo gjë që e domosdoshme. Të nesërmen e ballos zonjushat Lukas u gjendën në Longborn për të dëgjuar e bërë komente.

- Ti e fillove mbrëmjen mirë, Sharlot, - i tha znj. Benet zonjushës Lukas duke e mbajtur veten. - Ishe e para që zgjodhi z. Bingi.

- Po, po m'u duk se i pëlqeu më shumë vallëzimi i dytë.

- Ah, e ke fjalën për Xhejnin, me siguri, sepse me atë vallëzoi shumë mirë. Po pra, u duk se i pëlqeu - në të vërtetë kam bindjen se po. E dëgjova t'i shprehte diçka z. Robinson, s'më kujtohet mirë se çfarë.

- Ndoshta e keni fjalën për atë që më kapi veshi t'i thoshte z. Robinson. Nuk ta thashë ty? Z. Robinsoni po e pyeste si i kishin pëlqyer të pranishmit në Meriton, nëse nuk i dukej se kishte shumë gra të pashme në sallë dhe kush i pëlqente më shumë. Dhe ai ia ktheu menjëherë duke i thënë. A, vajza e madhe e Benetëve, pa pikë dyshimi, as diskutohet.

- Për besë! Po, po, foli fare hapur, duket sikur - megjithatë kjo s'do të thotë asgjë.

- Ajo që më kapi veshi mua ia vlejti më mirë se ajo që dëgjove ti, Eliza, - tha Charlota. - Z. Darsi nuk ia vlen të dëgjohet sa shoku i vet, apo jo? E gjora Eliza, je vetëm e pranueshme!

- Aman të lutem. Mos ia ço në mendje Lizit të mërzitit nga keqtrajtimi i tij, sepse ai është një person kaq antipatik, saqë është fatkeqësi të pëlqehesh prej atij. Znj. Long më tha dje që ai i që ulur afër rreth një gjysmë ore pa e hapur gojën fare.

- Je e sigurtë, mama? Më duket se ka një gabim këtu, - tha Xhejni. - Jam e sigurtë që e pashë z. Darsin t'i fliste.

- Eh, sepse ajo e kishte pyetur a i pëlqente Nedhërfildi dhe ai s'mund të rrinte pa iu përgjigjur, por ajo tha që dukej sikur nisja e muhabetit e kishte nevrikosur.

- Zonjusha Bingli më tha, - u hodh Xhejni, - që, ai flet shumë pak, kur nuk është me miqtë e tij të ngushtë. Me ata është shumë i lezetshëm.

- Nuk e besoj fare, zemra ime. Po të ishte kaq i lezetshëm do të kishte folur me znj. Long. Po e marr me mend se ç'tip është. Të gjithë thanë që ka një krenari fodulle dhe me siguri i ka rënë në vesh që znj. Long nuk mban karrocë dhe që iu desh të merrte një karrocë me para për të ardhur në ballo.

- S'më prishet puna se nuk foli znj. Long, - tha zonjusha Lukas, - por do kisha pasur dëshirë ta kishte marrë Elizën në vallëzim.

- Herën tjetër Lizi, - i tha e ëma, - po të isha në vendin tënd as do kërceja me të.

- Mama, them se mund ta premtoj që s'do të vallëzojë kurrë me të.

- Krenaria e tij, - tha zonjusha Lukas, - nuk më ofendon aq shumë sa të ofendon krenaria zakonisht, sepse e ka një arsye. S'ke pse çuditësh që një djalë i ri, aq zotni, me familje, pasuri dhe gjithçka të favorshme të jetë i kënaqur nga vetja. Nëse mund ta them troç, ai ka të drejtë të jetë krenar.

- Është shumë e vërtetë, - ia ktheu Elizabeta, - dhe do t'ia kisha falur krenarinë, sikur të mos më kishte cenuar atë timen.

- Them se krenaria, - vërejt Meri, e cila ishte e sigurtë për peshën e meditimeve të saj, - është një e metë shumë e përhapur. Me sa kam lexuar unë, jam e bindur që është vërtet shumë e përhapur dhe natyra njerëzore është e prirur ndaj saj. Të paktë janë ata që nuk ndiejnë një fare kënaqësie me një cilësi të tyren, reale apo të imagjinuar. Sqima dhe krenaria janë dy fjalë të ndryshme, megjithëse përdoren njësoj. Njeriu mund të jetë krenar pa qenë sqimatar. Krenaria ka më shumë të bëjë me vlerësimin që



ke për vetveten, kurse sqima me vlerësimin që do që të kenë të tjerët për ty.

- Po të isha aq e pasur sa z. Darsi, - tha njëri prej Lukasve që sapo erdhi me të motrat, - s' do më interesonte fare se sa krenar jam. Do mbaja një tufë me zagarë dhelprash dhe do pija çdo ditë një shishe verë.

- Kjo do të thotë që do pije më shumë se sa të bën mirë, - tha znj. Benet, - dhe po të të shihja duke pirë do të ta hiqja shishen në vend.

Djali e kundërshtoi, kurse ajo vazhdonte të ngulte këmbë dhe grindja u mbyll vetëm në fund të vizitës.

## Kapitulli gjashtë

**Z**onjat e Longbornit shumë shpejt i shkuan për vizitë atyre të Nedhërfildit. Vizita u kthye ashtu siç duhej. Sjellja e mirë e zonjushës Benet po rritej në sytë e znj. Hërst dhe zonjushës Bingli. Ndonëse këtyre të fundit, e ëma iu duk e padurueshme dhe motrat e vogla të nënvleftësueshme, ato kishin dëshirë të vazhdonin njohjen me dy të mëdhatë. Xhejnit i vinte mirë për konsideratën që tregonin, por Elizabeta ende kishte përshtypjen që iu dukej vetja superiore. Madje dukej sikur mezi e pranonin edhe të motrën, gjë që ia bënte Elizabetës të pamundur t'i pëlqente. Sidoqoftë mirësjellja e tyre kishte vlera akoma dhe më të mëdha duke qenë se reflektonte influencën e të vëllait. Në përgjithësi kur takoheshin, dukej hapur që ai e pëlqente Xhejnin dhe Elizabeta e shihte që e motra po fillonte t'ia lejonte vetes tërheqjen që kishte ndjerë në momentin e parë dhe në njëfarë mënyre kishte rënë në dashuri kokë e këmbë. Por vuri re me kënaqësi që kjo s'mund t'i binte në sy njeriu, sepse Xhejni ishte tip i përmbajtshëm dhe i çiltër me të gjithë, një përzierje që ajo e zotëronte mirë dhe e cila ruante prej dyshimeve të thashethemexhinjve. Këtë gjë Elizabeta e diskutoi dhe me shoqen e saj, zonjushën Lukas.

- Nga një anë, - tha Charlota, - është gjë e mirë të mos e japësh veten ndaj të tjerëve, por një kujdes kaq i madh edhe mund të prishë punë. Kur femra ia fsheh ndjenjat me të njëjtën zotësi edhe atij që do, mund ta humb të dashurin dhe pastaj i rroftë ngushëllimi që bota nuk ia mori vesh dashurinë. Marrëdhëniet zakonisht kërkojnë inkurajim, të rralla janë ato ku mirënjohja apo sqima nuk luan rol. Preferenca e parë lind vetvetiu, sepse njeriu është i lirë, por të rrallë janë ata që mund të dashurojnë vërtet pa inkurajim. Në nëntëdhjetë për qind të rasteve femrat duhet të tregojnë më shumë ndjenja se sa kanë vërtet. S'ka dyshim që Binglit jot motër i pëlqen, por mund të mbetet në këtë stad, në qoftë se Xhejni nuk i jep shenja inkurajuese.

- Po ajo i jep shenja me aq sa ia lejon tipi. Kur më bie mua në sy ndjenja që ka për të, ai duhet të jetë vërtet leshko mos ta kuptojë.

- Vetëm mos harro, që ai s'ia njeh natyrën Xhejnit, si ia njeh ti.

- Po kur femra do një mashkull dhe nuk ka për qëllim t'ia fshehë, ai do ta kuptojë.

- Ndoshta e kupton, kur kanë goxha kontakt. Edhe pse Xhejni dhe Bingli takohen shpesh, ata nuk kalojnë asnjëherë shumë orë bashkë dhe duke qenë se janë gjithmonë në prani të shumë njerëzve, është e pamundur të flasin gjithë kohën bashkë. Prandaj Xhejni duhet ta përdorë çdo gjysmë ore që kalon me të në maksimum. Pasi ta ketë në xhep, ka kohë të bjerë në dashuri sa të dojë.

- Plani yt është me vend, - ia ktheu Elizabeta, - nëse qëllimi i vetëm i femrës është një martesë e volitshme dhe po t'ia kisha vënë vetes për qëllim të merrja një burrë të pasur, do të ndiqja planin tënd. Por Xhejni nuk niset nga kjo gjë dhe nuk ka ndonjë paramendim. Ajo akoma s'e di as vetë se sa i pëlqen ai, lëre pastaj nëse është e arsyeshme apo jo. S'ka dy javë që e njeh. Ka vallëzuar katër herë me

të, e ka takuar një mëngjes në shtëpinë e tij dhe ka ngrënë katër herë drekë në praninë e tij. Kaq nuk mjafton për t'ia kuptuar tipin.

- Jo sipas përshkrimit tënd. Po të ishte fjala vetëm për një drekë, ndoshta do kishte marrë informacione rreth oreksit të tij, por mos harro që ato katër mbrëmje i kanë kaluar bashkë dhe katër mbrëmje nuk janë pak.

- Po, këto katër mbrëmje mjaftojnë për të marrë vesh që të dyve ju pëlqen me shumë *Njëzetënjëshi* se sa *Tregtia*<sup>1</sup>, por sa për kualitete, s'ma do mendja që kanë shpalosur kushedi se sa.

- Nejsë, - tha Charlota, - unë i uroj Xhejnit nga zemra sukses dhe po të martohej me të nesër, them se do kishte po aq mundësi të jetë e lumtur, sikur do të ishte po t'ia studionte karakterin një vit rresht. Lumturia në martesë është krejt punë fati. Edhe kur bashkëshortët e njohin mirë njëri-tjetrin, edhe kur janë shumë të ngjashëm para martesës, s'ka siguri që do të jenë të lumtur. Me kalimin e kohës ata ndryshojnë boll dhe për t'i ngritur nervat njëri-tjetrit. Sa më pak t'ia njohësh bashkëshortit huqet, aq më mirë është.

- Më bëre për të qeshur, Sharlot, por kjo s'është e logjikshme. Ti e di fare mirë që s'është dhe vetë s'do ta bëje.

Elizabetës, e cila e vëzhgonte interesin që z. Bingli tregonte ndaj të motrës, as që i shkonte në mendje që ajo vetë ishte kthyer në objekt vëzhgimi për shokun tjetër. Z. Darsi fillimisht mezi e kishte konsideruar të pashme, në ballo nuk e kishte pëlqyer fare dhe në takimet e mëpasshme vetëm e kishte kritikuar. Nuk kishte shumë që i kishte deklaruar vetes dhe miqve të tij që ajo vajzë nuk ka asnjë tipar të mirë, kur filloi të zbulonte që bukuria e syve të errët i jepte një hije të zgjuar. Ky zbulim poshtërues solli

---

<sup>1</sup> Këtu është fjala për dy lojëra që luhen me letra bixhozi.

të tjerë me vete. Sado që ai kishte vënë re më shumë se një mangësi simetrie<sup>1</sup>, ishte i detyruar ta pranonte që kishte trup të zhdërvjellët e të lezetshëm. Megjithëse ai vetë kishte deklaruar që mënyra si sillej ishte larg asaj të botës mondane; ajo e tërhiqte me çiltërsinë e saj lozonjare. Ajo vetë nuk i kishte nuhatur këto mendime. Për të, ai qe vetëm dikush që nuk tregohej asnjëherë i këndshëm dhe që nuk e kishte menduar aq të pashme sa për të vallëzuar me të.

Atij i hipi dëshira për ta njohur më mirë dhe, duke dashur t'i fliste, u detyrua të hynte në bisedë me ata që bashkëbisedonin me të. Rasti iu dha në shtëpinë e sër Uilliam Lukasit ku ishin mbledhur shumë njerëz.

- Ç'mendoi z. Darsi rreth bisedës që dëgjoji ndërmjet meje dhe kolonel Fosterit? - e pyeti ajo Sharlotën.

- Këtë e di vetëm z. Darsi.

- Por po ta shohë prapë, do t'ia bëjë të qartë që ia kam kuptuar lojën. Ka një shikim satirik dhe po s'ia ktheva, do ta marrë frikë.

Kur ai po iu afrohej, edhe pse s'kishte ndonjë qëllim t'iu fliste, zonjusha Lukas për ta sfiduar shoqen e saj nuk foli, gjë që e provokoi Elizabetën ta merrte vetë fjalën. Ajo iu kthye duke i thënë:

- Z. Darsi, a nuk ju duket se u shpreha jashtëzakonisht mirë, kur po e ngacmoja kolonel Forsterin të na organizonte një ballo në Meriton?

- U shprehët me pasion, por balloja është një temë që eksiton pasionin e grave.

---

<sup>1</sup> Xhejn Osten ngul këmbë që Elizabeta nuk përputhet me idealin e bukurinë femërore të epokës. Tiparet e saj nuk janë perfekte, simetria nuk është e përkryer, por shprehja e syve, e cila reflekton mprehtësinë e Elizabetës është ndoshta më tërheqëse se ç'do model i përkryer. Motra e Elizabetës është bionde, me lëkurë të bardhë dhe përputhej me idealin e femrës së bukur të shekullit XIX

- Sa i ashpër që jeni me ne.

- Do t'i vijë edhe asaj radha për ta ngacmuar, - tha zonjusha Lukas. - Do hap pianon dhe ti, Eliza, e di se ç'ndodh pastaj.

- Ç'mënyrë të çuditshme ke për të shprehur miqësinë. Gjithmonë do që t'i bie pianos e të këndoj para njerëzve. Po të isha sqimatare në muzikë, do më kishe hyrë shumë në punë, por duke qenë se s'jam, nuk kam dëshirë t'i bie për njerëz që janë mësuar të dëgjojnë artistët më të mirë. - Por pas këmbënguljes së zonjushë Lukasit ajo shtoi: - Mirë, mirë. Meqë do ti, ashtu do bëhet. - Dhe duke i hedhur një shikim të vrenjtur z. Darsit tha: - Ka një shprehje të vjetër që e njohin të gjithë: Ruaje frymën t'i frysh qullit. Dhe unë do ta ruaj timen për të kënduar.

Interpretimi i saj që i mirë, por në asnjë mënyrë i shkëlqyer. Pas nja dy këngësh dhe para se t'iu përgjigjej lutjeve të disave për të kënduar përsëri, e motra e zuri me padurim pianon. Meri, duke qenë e vetmja femër jo simpatike në familje, përpiquej të kompensonte me dije dhe aftësi, të cilat nuk humbte rast t'i shpaloste.

Meri nuk kishte as zgjuarsis as shije. Dhe sado që sqima kishte influencuar për mirë, e kishte bërë aq pedante dhe fodulle sa që i ulte vlerën edhe aftësive më të mëdha. Elizabeta me thjeshtësinë dhe çiltërsinë e saj, dëgjonte me kënaqësi edhe pse interpretimi i saj nuk ishte as sa gjysma e Merit. Meri, pas një koncerti të gjatë, e gëzuar filloi të merrte komplimente e lëvdata për arjet skoceze dhe irlandeze që ia kishin kërkuar motrat e saj të vogla. Këto, bashkë me disa vajza të Lukasve, ia kishin zënë të kërcyerit me nja dy-tre oficerë në fund të dhomës.

Z. Darsi qëndronte afër tyre, i heshtur dhe i indinjuar me këtë mënyrë të kalimit të mbrëmjes, pa asnjë bashkëbisedim dhe dukej kaq i zënë me mendimet e tij

saqë nuk e kishte ndjerë sërë Lukasin t'i afrohej, derisa ky i fundit nisi t'i thoshte:

- Sa i dëfren vallëzimi të rinjtë, apo jo z. Darsi? Në fakt nuk ka si vallëzimi. Për mua është një nga finesat e para të shoqërisë së civilizuar.

- Natyrisht, sër. Pa le që ka avantazhin të jetë shumë në modë edhe në shoqëritë më të pacivilizuara. Edhe njerëzit e egër dinë të kërcejnë.

Sër Uilliam vetëm buzëqeshi.

- Shoku juaj di të vallëzojë shumë mirë, - shtoi ai kur pa Binglin t'i bashkëngjitej grupit. - Dhe s'kam dyshim që dhe ju duhet të jeni shumë i zoti, z. Darsi.

- Sër, më duket se më patë në Meriton.

- Po, vërtet dhe qe një pamje që më kënaqi shumë. Vallëzoni shumë në Shën Xhejms?

- Asnjëherë, sër.

- S'mendoni se do të qe kompliment për shtëpinë tuaj?

- Është një kompliment që e evitoj sa herë të jetë e mundur.

- Atëherë duhet të keni një shtëpi në qytet.

Z. Darsi pohoi.

- Njëherë e një kohë më thoshte mendja të ngulesha në qytet, sepse më pëlqen shumë shoqëria e zgjedhur, por pata frikë se klima e Londrës nuk do t'i bënte mirë lejdi Lukasit.

Sër Uilliam heshti me shpresë që bashkëbiseduesi i tij ta merrte fjalën, por ky nuk kishte ndër mend. Kur pa që Elizabeta po u afrohej, i erdhi ideja të bënte një gjest të sjellshëm dhe e thirri:

- E dashur zonjusha Eliza, pse nuk jeni duke vallëzuar?

Z. Darsi lejomëni t'ju prezantoj këtë zonjushë si një partnere shumë të dëshirueshme. Nuk mund të refuzoni një bukuri të tillë. Dhe duke kapur dorën e saj, ai bëri t'ia jepte z. Darsit, i cili ishte gati ta merrte. Në atë moment

ajo e tërhoqi dorën dhe disi e turbulluar iu drejtua sër Uilliamit:

- Në të vërtetë sër, nuk kam ndër mend të vallëzoj. Ju lutem mos mendoni që erdha në këtë drejtim për të kapur një partner.

Z. Darsi, me një hije të rëndë, i kërkoi ta nderonte me dorën e saj, por më kot. Elizabeta ishte e vendosur dhe as sër Uilliam nuk e bindi dot:

- Zonjusha Eliza, po ju shquheni aq për vallëzim, saqë është e pamëshirshme të më privoni nga kënaqësia që kam kur ju shoh të vallëzoni. Dhe sado që këtij zotërisë nuk i pëlqen vallëzimi në përgjithësi, jam i sigurtë që do pranonte të na e bënte qejfin për një gjysmë ore.

- Z. Darsi është mirësjellja vetë, - tha Elizabeta duke buzëqeshur.

- Ajo as që diskutohet, por kur ka një stimul si ky, gatishmëria e tij vetëkuptohet. Kush mund të kundërshtojë një partnere të tillë?

Elizabeta i hodhi një shikim dinak duke u larguar. Rezistenca e saj nuk ia kishte prishur qejfin xhentëlmenit. Ai po e mendonte me vetëkënaqësi kur zonjusha Bingli iu drejtua:

- E marrë me mend se ç'po meditoni?

- Them se jo.

- Jeni duke menduar se sa e padurueshme është të kalohen mbrëmjet kështu, me këtë lloj shoqërie dhe në fakt, jam dakord me ju. Rrallë jam mërzitur si sot. Ç'mungesë shijeje dhe çfarë zhurme! Njerëz kaq kot dhe kaq të sigurtë në vetvete.

- Ju siguroj që hamendja juaj është krejt e gabuar. Isha duke bluar mendime më të këndshme, sepse po meditoja se sa hijeshi i shtojnë fytyrës së gruas një palë sy tërheqës.



Në atë moment, zonjusha Bingli filloi ta vëzhgonte duke dashur të dinte se cila femër i kishte dhënë një frymëzim të tillë mendimeve të tij. Z. Darsi ia priti me guxim:

- Zonjusha Elizabeta Benet.

- Zonjusha Elizabeta Benet! - përsëriti zonjusha Bingli.

- Po më lini me gojë hapur. Sa kohë ka që e preferoni? Dhe më thoni kur duhet t'ju transmetoj urimet e mia?

- E dija që do ma bënit këtë pyetje. Femrat, me imagjinatën e shprehur që kanë, fluturojnë nga pëlqimi në dashuri dhe nga dashuria në martesë. Isha i sigurtë që do më uronit.

- Aha, ama meqë e keni marrë kaq seriozisht, e konsideroj të bërë. Ç'vjehtë simpatike që do keni dhe gjithmonë të pranishme në Pembërli.

Ai e dëgjonte me një indiferencë totale, ndërsa ajo argëtohej me veten e saj. Kur qëndrimi i tij e bindi që s'kishte vend për t'u frikësuar, zgjuarësia e saj mori krahë.

## Kapitulli shtatë

Gjithë e gjithë pasuria e z. Benet përmbli dhej në një pronë me vlerë dy mijë paund në vit, që për fat të keq të vajzave të tij, do t'i kalonte një kushëriri të largët, duke qenë se ai nuk kishte vetë trashëgimtar. Pasuria e znj. Benet, edhe pse e mjaftueshme për atë vetë, nuk mund të kompensonte atë të të shoqit. I ati i saj kishte qenë avokat në Meriton dhe i kishte lënë së bijës katër mijë paund.

Ajo kishte një motër të martuar me z. Philips, ish-sekretarin e të atit, i cili pas vdekjes së këtij mori përsipër biznesin e familjes dhe një vëlla në Londër, një tregtar të respektuar.

Fshati i Longbornit ishte vetëm një milje larg Meritonit, distancë e favorshme për zonjushat, që s'duronin dot pa shkuar tre-katër herë në javë që të nderonin tezen e tyre dhe një dyqan kapelash<sup>1</sup> aty afër. Katerinës dhe Lidias, që ishin më të rejat e familjes, iu shkonte mendja më shpesh se të tjerave, sepse ishin më të lira se sa motrat e tyre. Kur s'kishin ç'bënin, një shëtitje nga Meritoni ishte e nevojshme për të mbushur paraditet me dëfrim dhe mbrëmjet me thashetheme. Dhe sado pak të reja të

---

<sup>1</sup> Ky lloj dyqani nuk kishte vetëm kapela, por dhe artikuj të tjerë si dorashka, kordele, etj.

qarkullonin në provincë, ato zbulonin ndonjë nga teza. Për momentin, arritja e një regjimenti oficerësh në rajon i kishte furnizuar mirë me të reja dhe lumturi. Ata do ta kalonin dimrin aty, sepse Meritoni ishte baza.

Vizitat te znj. Filips ishin më se produktive, sepse ofronin lajme shumë interesante. Çdo ditë i pasuronte me të reja rreth emrave dhe lidhjeve të oficerëve. Banesat e tyre s'ishin më sekret dhe jo vonë ato mësuan emrat e oficerëve. Z. Filips iu shkoi të gjithëve për vizitë, gjë që qe një burim lumturie të paparë për mbesat e tij. Nuk pushonin së foluri rreth oficerëve dhe kur binte fjala për pasurinë e z. Bingli ndërkohë që e ëma gjallërohej, të bijave nuk i hynte gjë në sy përveç emblemave të regjimentit.

Një mëngjes pasi kishte dëgjuar një lumë fjalësh rreth kësaj teme, z. Benet vërejti me indiferencë:

- Me sa më kanë dëgjuar veshët, them se nuk ka në botë vajza më budallaçka se ju të dyja. E kam dyshuar me kohë, por tani u binda.

Katerina e humbi për një moment dhe heshti, kurse Lidia, tërësisht indiferente, vazhdoi të lavdëronte kapiten Karterin, duke shtuar që uronte ta takonte para se ai të nisej për Londër.

- Po më habit i dashur, - tha znj. Benet, - si s'e ke fare problem t'i quash vajzat e tua budallaqe. Po të isha në vendin tënd dhe të doja të shaja fëmijët e dikujt, nuk do shaja të mitë.

- Po kur fëmijët e mi janë budallenj, unë këtë gjë dua ta di.

- Po, po. Por puna është që ato janë shumë të zgjuara.

- Them se kjo është e vetmja gjë për të cilën nuk jemi dakord. Kisha shpresuar të na puqeshin mendimet në çdo pikë, por jam i detyruar të them që në këtë rast kemi mendime të kundërta dhe që vajzat tona janë jashtëzakonisht të lehta nga mendtë.

- I dashur z. Benet, po mos prit prej vajzave të kenë mençurinë e babait ose nënës së tyre. Kur të bëhen sa ne, s'do ta kenë mendjen tek oficerët më shumë seç e kemi ne. Mua më kujtohet vetja se sa më pëlqente uniforma e kuqe dhe thellë-thellë vazhdoj ta kem qejf. Pastaj, nëse një oficer për të qenë, me pesë ose gjashtë mijë paund në vit, ma kërkon njërën prej vajzave, unë s'do t'i them jo. Kolonel Forsteri dukej goxha zotëri i veshur me uniformë dje te sër Uilliami.

- Mama, - bërtiti Lidia, - te zja thotë që kolonel Forsteri dhe kapiten Karteri nuk shkojnë më aq shpesh si në fillim te zonjusha Uatson. Tani i ka parë shpesh në librarinë e Klarkut.

Z. Benet nuk arriti të përgjigjej, sepse një korrier ishte futur në dhomë me një letër për zonjushën Benet. Letra vinte nga Nedhërfildi dhe korrieri po priste një përgjigje. Znj. Benet i shkëlqenin sytë nga gëzimi dhe bërtiste me padurim, ndërsa e bija lexonte:

- Hë moj Xhej? Kush e ka dërguar? Çfarë është? Ç'kanë shkruar? Po hë, moj Xhej, jepi shpejt, na llafos, nxitohu zemra ime.

- E dërgon zonjusha Bingli, - tha Xhejni dhe e zuri ta lexonte me zë të lartë:

“E dashur mikja ime!

Po nuk pate mëshirë të darkosh me mua dhe Luizën sot, ka rrezik që ne të dyja ta urrejmë njëra-tjetrën njëherë e përgjithmonë, sepse kur dy femra janë gjithë ditën bashkë, s'ndahen dot pa ndonjë sherr. Eja sa më shpejt të jetë e mundur. Im vëlla dhe zotërinjtë e tjerë do darkojnë me oficerët. Përgjithmonë jotja, Karolina Bingli”.

- Me oficerët, - klithi Lidia, - mua te zja s'më tha gjë.

- Do hanë darkë jashtë, - tha znj. Benet, - ç'fat i keq.

- Mund të shkoj me karrocë? - pyeti Xhejni.

- Jo, zemër, më mirë shko me kalë, sepse me sa shoh do bjerë shi dhe do jesh e detyruar ta kalosh natën atje.

- Ky plan mund të qëndronte, - tha Elizabeta, - po të ishte e sigurtë që ata nuk e shoqëronin vetë me karrocë.

- Ua, por burrat do kenë marrë kaloshinën për në Meriton dhe znj. dhe z. Hërst nuk kanë kuaj.

- Do doja të shkoja me karrocë.

- Ama, e dashur, kuajt i duhen babait në fermë, jam e sigurtë që s'bën dot pa ta, apo jo, z. Benet?

- Më duhen sa më s'ka.

- Po meqë po thotë mamaja, - tha Elizabeta, - tani të duhen e të duhen.

Më në fund Elizabeta e bëri të atin të thoshte troç që kuajt ishin të zënë dhe Xhejnit iu desh t'i hipte kalit. E ëma e shoqëroi te dera, duke parashikuar shumë e lumtur prishjen e motit. Dhe pati të drejtë, sepse Xhejni nuk kishte pak që ishte nisur, kur ia nisi shiu vendçe. Të motrat u bënë merak për të. E ëma ishte në qiellin e shtatë. Shiu nuk pushoi gjatë gjithë mbrëmjes dhe Xhejni e kishte të pamundur të kthehej.

- Sa mirë më vajt mendja mua, - mbeti duke thënë znj. Benet, sikur rënia e shiut qe plotësisht merita e saj.

Deri të nesërmen në mëngjes ajo nuk ishte krejtësisht e ndërgjegjshme për dobishmërinë e këtij komploti. Sapo kishin mbaruar mëngjesin, një shërbëtor solli një letër për Elizabetën nga Nedhërfildi:

“E shtrenjta ime, Lizi!

Sot në mëngjes jam gdhirë pa qejf, ma do mendja, sepse u bëra qull dje. Miqtë e mi të dashur nuk duan të më lënë të kthehem në shtëpi, derisa të marr veten. Kanë ngulur këmbë të thërrasin z. Xhonsin, prandaj mos u bëni merak, po të merrni vesh që më ka ekzaminuar. Hiq një dhimbje gryke dhe një dhimbje koke, s'ka asgjë shqetësuese. E jotja, etj.”.

- Hë e dashur, - tha z. Benet, pasi Elizabeta mbaroi së lexuari, - tani, nëse vazhën e kap ndonjë sëmundje e

rrezikshme dhe vdes, të paktën kemi ngushëllimin që gjithçka ndodhi për hir të z. Bingli dhe me urdhrin tënd.

- S'kam frikë se vdes. S'vdes njeriu nga një e ftohtë e thjeshtë. Atje do kujdesen mirë për të. Sa kohë që është atje, s'ka problem. Do shkoja ta shihja, po ta kisha karrocën.

Elizabeta ndihej vërtet në ankth dhe vendosi të shkonte edhe pse nuk e kishte karrocën në dispozicion. Duke qenë se asaj vetë nuk i jepej për të kalëruar, i mbeti të shkonte në këmbë. Këtë vendim e deklaroi.

- Sa budallaqe që bëhesh, - tha e ëma, - as mos e shko ndër mend, me gjithë këtë baltë. Nuk do jesh për t'u parë me sy kur të mbërrish atje.

- Do të jem në rregull për të parë Xhejnin dhe ky është qëllimi im.

- Lizi, je duke më thënë larg e larg që të bëjë gati kuajt? - tha i ati.

- Jo, vërtet. S'e kam problem të ecurën. Kur ka një arsye, tre milje s'janë hiç gjë. Do kthehem në darkë.

- Mirëdashja jote është për t'u admiruar, - vërejti Meri, - por arsyeja është ajo që udhëheq impulset e ndjenjave. Për mendimin tim, mundimi duhet të jetë në raport me rrethanat.

- Do të të shoqërojmë ne deri në Meriton, - tha Lidia dhe Katerina. Elizabeta pranoi dhe tri zonjushat u nisën për rrugë. - Po t'i hedhim këmbët, - tha Lidia në ecje e sipër, - ndoshta shohim kapiten Karterin para se të niset.

Në Meriton u ndanë. Dy të voglat u drejtuan për te banesa e bashkëshortes së një prej oficerëve, kurse Elizabeta vazhdoi vetëm, duke përshkuar një fushë pas tjetrës me hap të shpejtë, duke kalur shkallëzat dhe kapërcyer pellgjet me gjallëri e padurim, derisa i kapi syri shtëpinë. Kishte arritur e lodhur, me çorape të ndotura dhe fytyrën e ndezur flakë prej sforcimit fizik.

Kur shërbëtori e shoqëroi në dhomën e mëngjesit, të gjithë, përveç Xhejnit që s'ishte e pranishme, mbetën me gojë hapur. Zonjushës Binglit dhe znj. Hërst nuk u besohej që kishte ecur tre milje në pikë të mëngjesit, fillikat dhe në një mot të tillë. Elizabeta ishte e sigurtë që me mendjen e tyre ato e përçmonin. Sidoqoftë e pritën sjellshëm. Sjellja e vëllait të tyre nuk reflektonte vetëm mirësjellje, por diçka më të mirë akoma, humor të ngrohtë dhe përzemërsi. Z. Darsi foli fare pak, kurse z. Hërst aspak. Zotëria i parë që i lëkundur. Nga një anë e tërhiqte shkëlqimi që ushtrimi fizik i kishte dhënë fytyrës së saj, nga ana tjetër ishte gjithë dyshim nëse ishte i justifikuar gjithë ai mund. Zotëria i fundit e kishte mendjen vetëm te mëngjesi.

Rreth së motrës nuk mori ndonjë lajm të mirë. Zonjusha Beneti kishte fjetur keq dhe duke qenë se kishte temperaturë nuk kishte dalë nga dhoma. Elizabeta u kënaq që e çuan tek e motra pa humbur kohë. Xhejni u lumturua kur e pa. Ajo e kishte dëshiruar shumë një vizitë të tillë, por nuk ishte shprehur, sepse nuk donte ta bënte merak e ta bezdiste familjen e saj. Megjithatë nuk kishte fuqi të fliste dhe kur zonjusha Bingli u largua, vetëm shprehu mirënjohje për trajtimin jashtëzakonisht të mirë që i kishin bërë dhe nuk foli shumë. Elizabeta rrinte e heshtur pranë saj.

Kur mbaruan mëngjesin erdhën dhe dy motrat e shtëpisë dhe Elizabeta filloi t'i pëlqente kur pa se sa kujdeseshin për të motrën. Doktor mbërriti dhe pasi e kishte ekzaminuar të sëmurën, tha, siç merrej me mend, që ishte ftohje e rëndë dhe që duhet ta merrnin seriozisht. Të sëmurën e këshilloi të kthehej në shtrat dhe i premtoi t'i sillte ilaçe.

Kjo këshillë u ndoq pa një pa dy, sepse shenjat e etheve u shtuan dhe i filloi një dhimbje koke e fortë. Elizabeta

nuk doli fare nga dhoma e saj. Edhe dy motrat rrallë u larguan, sepse në fakt kur meshkujt s'ishin aty, ato s'dinin si ta mbushnin kohën.

Kur vajti ora tre, Elizabeta e ndjeu dhe tha që duhet të largohej, por fare pa dëshirë. Zonjusha Bingli i ofroi karrocën, të cilën e pranoi pa rezistuar shumë. Por kur Xhejni nuk po ndahej dot prej së motrës, zonjusha Bingli u detyrua ta shndërronte ofertën e karrocës në ftesë për të qëndruar në Nedhërfild. Elizabeta pranoi me mirënjohje dhe një shërbëtor u nis të lajmëronte familjen në Longborn e të sillte rroba rezervë për Elizabetën.



## Kapitulli tetë

Në orën pesë dy zonjat e shtëpisë shkuan të visheshin për drekë dhe në gjashtë e gjysmë Elizabetës iu tha që darka qe gati. Një mori pyetjesh vërshoi rreth të sëmures, ndër të cilat, Elizabeta spikati me kënaqësi interesimin e z. Bingleit. Të rejat rreth Xhejnit nuk qenë pozitive. Dy motrat kur dëgjuan këtë lajm murmuritën disa herë se sa keq u vinte për Xhejnin, sa i keq qe i ftohti dhe sa bezdi i kishin ato sëmurdjet. Pas kësaj e harruan këtë temë dhe indiferenca e tyre ndaj Xhejnit, kur kjo nuk ishte e pranishme, e bëri Elizabetën t'i gëzohej përshtypjes që i kishin lënë në fillim.

Nga të pranishmit, vetëm i vëllai i binte në sy për mirë. Dukej vërtet në ankth për Xhejnin dhe tregohej kaq i vëmendshëm ndaj Elizabetës sa që falë tij ajo nuk e ndjeu veten të huaj, ndërkohë që ishte e sigurtë që të tjerët e konsideronin të tillë. Përveç tij të tjerët ia varën fare pak. Zonjushë Bingli i qe përkushtuar z. Darsit, znj. Hërst po ashtu. Ndërsa z. Hërst, afër të cilit ishte ulur Elizabeta, qe një mashkull i plogët, që jetonte vetëm për të ngrënë, për të pirë e për të lozur me letra. Kur ky mori vesh që Elizabetës i pëlqenin gatimet e thjeshta më shumë se sa raguja, nuk ia adresoi më fjalën.

Pas drekës, Elizabeta u kthye direkt te Xhejni dhe zonjusha Bingli filloi ta shante me të dalë nga pragu i derës. Sjelljen e saj e quajti vërtet shumë të rëndomtë, një përzierje krenarie dhe pafytyrësie. Zonjusha Eliza Benet s'dinte të fliste, s'kishte hije moderne, as shije e as bukuri. Znj. Hërst qe dakord me këtë përshkrim dhe shtoi:

- Shkurt fare, nuk ka asgjë pozitive, përveç se di të ecë mirë. S'do ta harroj kurrë në ç'gjendje na u paraqit në mëngjes. Dukej gati si e tërbuar.

- Tamam ashtu dukej, Luiza. Mezi e mbajta veten. Ç'mendjelehtësi e shtyu të merrte gjithë atë rrugë? Pse do t'i binte anë e mbanë provincës për një të ftohur të së motrës. Me ato flokë rrëmujë e të shkatërruar.

- Po zhuponi! Me siguri e vure re zhuponin, as diskutohet, i zhytur dy pëllëmbë në baltë dhe e pe si e kishte lëshuar fustanin për ta mbuluar, por pa sukses.

- Përshkrimi yt mund të jetë i saktë Luiza, - tha z. Bingli, - por unë s'i vura re këto që thua ti. Zonjusha Benet për mua dukej shumë mirë, kur hyri në dhomë. Zhuponi i ndotur as më ra në sy fare.

- Por ju e vutë re, z. Darsi, jam e sigurtë, - tha zonjushë Bingli, - dhe ma do mendja që s'do t'ju pëlqente që motra juaj të paraqitej ashtu.

- Patjetër që jo.

- Të ecësh tre milje, ose katër ose pesë, ose ç'rëndësi ka sa, e futur në baltë deri në kyç dhe vetëm, fillikat vetëm. Ç'i thotë mendja asaj? Më duket një shenjë pavarësie fodulle dhe e paturpshme, një indiferencë totale ndaj rregullave të etiketës.

- Për mua është një shenjë dashurie ndaj së motrës dhe më pëlqen shumë, - tha Bingli.

- Kam frikë z. Darsi se kjo aventurë, - vërejtji gati duke pëshpëritur zonjushë Bingli, - do t'ia ketë ulur vlerën syve të saj.

- Aspak, - u përgjigj ai, - sforcimi ua kishte shtuar shkëlqimin. - Të gjithë heshtën derisa znj. Hërst ia nisi përsëri.

- Jam shumë e apasionuar pas Xhejn Benetit, sepse ajo është vërtet vajzë e dashur dhe i uroj nga zemra të rregullohet mirë në jetë. Po me atë nënë e babë që ka dhe me atë rreth familjar, kam frikë se s'ka shans.

- Më duket të dëgjova të thojë që kanë një xhaxha avokat në Meriton.

- Po, por kanë edhe një që jeton në lagjen e lirë të Londrës.

- Mrekulli fare, - tha motra tjetër dhe të dyja ia shkrepën së qeshurës.

- Edhe po të kishin xhaxhallarë sa për të mbushur gjithë lagjen e lirë, - bërtiti z. Bingli, - s'do ishin asnjë grimë më pak të këndshme.

- Por do të kishin shanse goxha të dobëta për të marrë një burrë sadopak të pranueshëm, - ia ktheu Darsi.

Z. Bingli nuk iu përgjigj, por të motrat e miratuan me përzemërsi dhe vazhduan të dëfreheshin duke tallur të afërmit e shoqes së tyre të dashur.

Me një vrull të ri ndjenjash dolën nga dhoma e ngrënies për t'i ndenjur pranë të sëmurës derisa vajti ora për kafënë.<sup>1</sup> Xhejni vazhdonte të ishte pa qejf dhe Elizabeta nuk e la asnjë minutë vetëm. Kur e motra ra në gjumë vendosi të zbriste poshtë më shumë me detyrim se sa kënaqësi. Kur u fut në dhomën e ndenjjes, i gjeti të gjithë duke luajtur bixhoz. Ata e ftuan në lojë, por ajo refuzoi duke menduar se duhet të luanin me shuma të larta. Si pretekst nxori sëmundjen e së motrës dhe tha se për aq sa do të rrinte poshtë, i mjaftonte një libër.

---

<sup>1</sup> Në këtë moment edhe zotërinjtë kanë mbaruar drekën.

- Pëlqekeni më shumë librat se sa lojërat me letra, - tha z. Hërst, - e çuditshme.

- Zonjushë Eliza Benet i urren letrat, - tha zonjushë Bingli, - ajo është e dhënë pas leximit dhe nuk i jep tjetër gjë kënaqësi.

- S'ë meritoj as lëvdatën, as kufizimin, - u hodh Elizabeta, - sepse nuk lexoj shumë dhe më japin shumë gjëra kënaqësi.

- Me siguri, që të kujdeseni për motrën tuaj ju jep kënaqësi, - tha z. Bingli, - dhe uroj të shërohet sa më shpejt për t'ju dhënë kënaqësi edhe më të madhe.

Elizabeta e falënderoi me gjithë zemër dhe u drejtua te një tavolinë me libra. Ai ishte gati t'i sillte menjëherë të tjerë. Të gjithë librat e bibliotekës së tij.

- Uroja që koleksioni im të ishte më i madh për t'ju ofruar më shumë libra dhe për t'i rritur vlerat vetes, por jam dembel dhe rrallë iu hedh sytë dhe atyre pak që kam.

Elizabeta e siguroj që ata që ishin aty i mjaftonin.

- Po habitem, - tha zonjushë Bingli, - që im atë paska patur një koleksion kaq të vogël. Ç'bibliotekë të mrekullueshme keni ju në Pembërli, z. Darsi!

- Duhet të jetë e mirë, - ia ktheu ai, - është fruti i punës të disa brezave.

- Por dhe ti ke shtuar shumë dhe vazhdon të blesh akoma.

- Nuk i kuptoj se si njerëzit i neglizhojnë bibliotekat familjare sot.

- Sa për neglizhim, jam e sigurtë që ti nuk neglizhon asgjë që mund t'i shtojë hijeshinë atij vendi aq fisnik. Çarls kur të ndërtosh shtëpinë tënde uroj të të dalë sa gjysma e Pembërlit.

- Ashtu qoftë!

- Por të këshilloj të blesh një tokë në atë krahinë dhe të marrësh Pembërlin si shembull, sepse nuk ka vend më të zgjedhur se Darbishër në të gjithë Anglinë.

- Me gjithë qejf. Po ta shiste Darsi Pembërlin, do ta bleja në vend.

- Unë po flas për gjëra të mundshme, Çarls.

- Për nder Karolinë, më duket më e mundur të arrijë ta blejë Pembërlin se sa ta imitojë<sup>1</sup>.

Elizabeta ndiqte me kaq interes bisedën saqë s'e kishte fare mendjen te libri dhe dikur e lëshoi mënjanë. Duke iu afruar tavolinës së letrave, zuri vend ndërmjet z. Binglit dhe motrës së tij të madhe për të vëzhguar lojën.

- Është zgjatur shumë zonjusha Darsi nga pranvera e deri tani? - pyeti zonjushë Bingli. - Do më arrijë mua.

- Them se po. Hëpërhë është gati sa zonjusha Benet, ndoshta dhe diçka më e gjatë.

- Sa dëshirë kam ta shoh! S'kam takuar njeri që të më ketë kënaqur sa ajo. Ç'paraqitje, ç'sjellje dhe aq e kompletuar për moshën e saj. Zotësia e saj si pianiste është e paparë.

- S'di nga e gjejnë vajzat e sotme, - tha z. Bingli, - gjithë atë durim që kërkohet për të qenë aq të kompletuara sa janë.

- Të gjitha vajzat e kompletuara! I dashur Çarls, ku e ke fjalën?

- Mendoj se të gjitha janë të kompletuara. Të gjitha pikturojnë tavolina, qëndisin e thurin çanta. Zor se njoh një që s'di t'i bëj këto dhe jam i sigurtë që s'më ka ndodhur të më përshkruhet një vajzë pa thënë që është e kompletuar.

- Lista e aftësive që përmende ti është më se e vërtetë, - tha z. Darsi. - E kompletuar quhet çdo grua që di të thurë çanta ose të qëndisë. Por nuk jam fare dakord me vlerësimin që ke ti për gratë në përgjithësi. Në të gjithë rrethin tim shoqëror, s'mund të mburrem e të them se njoh më shumë se gjashtë gra, që janë vërtet të kompletuara.

---

<sup>1</sup> Aludohet që shumë bukuri natyrore nuk imitohen dot prej dorës së njeriut.

- As unë jo, jam e sigurtë.  
- Atëherë, - vërejtí Elizabeta, - ju duhet të keni kërkesa shumë të larta ndaj një gruaje të kompletuar.

- Ashtu është.

- Po, patjetër, - u hodh ndihmësja e tij besnike, - kush nuk e tejkalon të zakonshmen, s'mund të konsiderohet e kompletuar. Një femër duhet të ketë njohuri të mira muzikore, kantoje, vizatimi, vallëzimi dhe të gjuhëve moderne, për ta merituar atë fjalë. Përveç kësaj, po nuk pati dhe diçka më shumë në mënyrën si prezantohet, në të ecurën e të folurën, si ju drejtohet të tjerëve dhe si shprehet, atëherë nuk e meriton plotësisht atë epitet.

- Këto cilësi duhet t'i ketë, - vazhdoi z. Darsi, - dhe përveç atyre duhet të bëjë dhe diçka më të rëndësishme. Duhet ta zgjerojë horizontin e saj duke iu përkushtuar leximit.

- Aha, tani s'më habit më fakti që njihni vetëm gjashtë gra të tillë, përkundrazi çuditëmi që njihni ndonjë.

- Kaq e ashpër tregoheni ju me seksin tuaj, saçë e vini në dyshim?

- S'kam ndeshur kurrë një femër të tillë. Këto cilësi, aftësi, shije e elegancë që thoni ju, nuk i kam parë kurrë të grumbulluara tek i njëjti person.

Znj. Hërst dhe zonjushë Bingli ngritën zërin kundër padrejtësisë së këtij dyshimi dhe protestuan duke thënë se ato njihnin shumë femra në përputhje me përshkrimin e z. Darsit. Në këtë moment z. Hërst iu bëri thirrje, duke u ankuar me mllef për pavëmendjen e tyre. Kjo i dha fund gjithë bisedës dhe pak më vonë Elizabeta doli nga dhoma.

- Eliza Benet, - tha zonjusha Bingli, sapo Elizabeta mbylli derën, - është një nga ato vajzat e reja që duan të fitojnë pikë te seksi i kundërt, duke ulur të tyrin. Dhe në

fakt kanë sukses me shumë meshkuj. Por për mendimin tim, është një mënyrë shumë e ulët, e neveritshme.

- S'ka dyshim, - tha z. Darsi, të cilit i qe drejtuar kryesisht ky koment, - çdo mjet që përdorin femrat herë-herë për të peshkuar meshkujt është i ulët. Dhe gjithçka që ka të bëjë me dinakëri është e neveritshme.

Zonjushë Bingli nuk mbeti aq e kënaqur me këtë përgjigje sa për ta vazhduar bisedën. Elizabeta u kthye dhe njëherë për t'u thënë që gjendja e Xhejnit që keqësuar dhe që nuk mund ta linte vetëm. Bingli këmbënguli të thirrej menjëherë z. Xhons, ndërsa të motrat e bindën që nga një mjek fshati nuk kishte ç'pritej më shumë dhe rekomanduan të thirrej menjëherë një nga mjekët më me emër të qytetit. Elizabeta e refuzoi këtë propozim, por ishte gati të pranonte atë të vëllait të tyre. Vendosën të thërrisnin z. Xhons të nesërmen herët, nëse zonjushë Beneti nuk gdhihej më mirë. Bingli ishte në siklet, ndërsa të motrat deklaruan që ishin të hidhëruara. Ato e lehtësuan hidhërimin e tyre me duete pas drekës, kurse Bingli s'dinte si ta qetësonte veten, përveç se duke porositur amvisën e shtëpisë, që t'i plotësonte çdo nevojë zonjushës së sëmure dhe së motrës.

## Kapitulli nëntë

**E**lizabeta e kaloi gati gjithë natën në dhomën e së motrës dhe në mëngjes pati kënaqësinë t'i kthente përgjigje pozitive z. Binglit, nëpërmjet shërbyeses që kishte dërguar që herët në mëngjes dhe dy zonjave elegante që u kishin ardhur për vizitë motrave të tij. Pavarësisht nga ky përmirësim, kërkoi të shkonte dikush në Longborn, për të lajmëruar t'ëmën të vinte e të shikonte Xhejnin dhe të gjykonte vetë se ç'duhej bërë. Letra u dërgua dhe kërkesa u plotësua pa humbur kohë. Znj. Benet arriti në Nedhërfild pas vaftit të mëngjesit, e shoqëruar prej dy vajzave të vogla.

Po ta kishte gjetur Xhejnin në gjendje të rrezikshme, znj. Benet do të ishte pikëlluar, por kur pa e kënaqur që e bija s'kishte asgjë për t'u alarmuar, nuk donte të shërohej shpejt, sepse me t'u shëruar duhet të largohej nga Nedhërfildi. Prandaj e kundërshtoi propozimin e së bijës për ta marrë me vete në Longborn, gjë që as mjeku që arriti njëkohësisht nuk e rekomandoi. Pasi ndenjën pranë Xhejnit një copë herë, e ëma dhe të tre motrat ndoqën zonjushë Binglin në dhomën e mëngjesit që kishte ardhur për t'i ftuar. Bingli i priti gjithë shpresë që znj. Benet e kishte gjetur të bijën në një gjendje jo aq të keqe sa ç'e priste.



- Të them të drejtë jo, sër, - qe përgjigjja. - Është shumë e sëmure për ta marrë me vete në Longborn. Z. Xhons thotë që s'mund të bëhet fjalë për ta lëvizur tani. Jemi të detyruar të përfitojmë nga mirësia juaj edhe pak.

- Për ta lëvizur, - ia briti Bingli, - as që mos t'ju shkojë në mendje. Jam i sigurtë, që ime motër është tërësisht kundër.

- Zonjë, të jeni e sigurtë, - tha zonjushë Bingli me një mirësjellje të ftohtë, - që sa kohë të jetë me ne, ne nuk do të lejojmë t'i mungojë asgjë.

Znj. Benet iu përgjigj me një mijë falënderime.

- Për këtë jam e sigurtë, - shtoi pastaj. - S'e di si do t'i kishte vajtur filli asaj vajze, po të mos kish patur kaq miq të mirë, sepse është vërtet sëmure dhe po vuan shumë. Megjithëse s'ka në botë aq të durueshme sa ajo; kështu ka qenë gjithmonë dhe vazhdon të jetë, vajza më e dashur që më kanë zënë sytë. I them vajzave të tjera që s'janë as sa gjysma e Xhejnit. Sa të bukur e paskeni këtë dhomë, z. Bingli dhe me këtë pamje të lezetshme të shtegut me zhavor. S'kam parë kurrë vend kaq të bukur sa Nedhërfildi. Uroj mos të vendosni të largoheni shpejtë e shpejtë, edhe pse keni qira të shkurtër.

- Unë të gjitha gjërat i bëj shpejt e shpejt, - iu përgjigj ai, - prandaj po të vendos të largohem nga Nedhërfildi, me siguri brenda pesë minutash jam i ikur. Për momentin e konsideroj veten të shpërngulur këtu.

- Kjo është tamam përshtypja që më keni lënë, - tha Elizabeta.

- Ju më kuptoni, apo jo, - thirri ai, duke iu drejtuar asaj.

- Po, po. Ju kuptoj plotësisht.

- Uroj ta konsideroj këtë kompliment. Po të jesh kaq i depërtueshëm për të tjerët, është për të ardhur keq.

- Varet. Kjo s'do të thotë që një tip i thellë e i mbyllur ka më shumë vlera se sa një tip si juaji.

- Lizi, - ia briti e ëma, - mos harrove gjë ku je? Mos e lësho gjuhën pa fre, siç e bën në shtëpi.

- S'e dija që ju merreni me studimin e tipave, - vazhdoi Bingli menjëherë, - duhet të jetë interesante.

- Po, por tipat e mbyllur janë më zbatimësit. Të paktën këtë përparësi e kanë.

- Por provinca, - tha Darsi, - në përgjithësi ofron pak raste studimi. Fqinjëria e një province është shumë e kufizuar, kështu që është shoqëri monotone.

- Po njerëzit ndryshojnë shumë dhe ka të reja për të vëzhguar gjithmonë.

- Tamam, - u hodh znj. Benet, e prekur kur dëgjoji të flitej kështu rreth fqinjërisë së provincës. - Ju siguroj që sa për atë është njësoj si në provincë apo në qytet.

Të gjithë mbetën të habitur dhe Darsi pasi i nguli sytë një moment, i ktheu nga ana tjetër në heshtje. Znj. Benet, duke menduar se kishte korrur fitore ndaj tij, vazhoi triumfatore.

- S'më duket se Londra ka ndonjë gjë më shumë se sa provinca, përveç dyqaneve dhe vendeve publike. Provinca është shumë më e këndshme se qyteti, apo jo z. Bingli?

- Kur jam në provincë, - u përgjigj, - s'më bëhet të iki. Por dhe kur jam në qytet më ndodh e njëjta gjë. Secila ka të mirat e veta. E ndiej veten mirë në të dyja.

- Eh, po sepse keni qëndrimin që duhet. Por atij zotërisë, - duke i hedhur sytë z. Darsit, - duket që s'i hyn në sy provinca.

- Jo, mama, e ke gabim, - tha Elizabeta e turpëruar prej s'ëmës. - E keqkuptove z. Darsin. Ai donte të thoshte që provinca nuk ka atë shumëllojshmëri njerëzish që ofron qyteti. Këtë e pranon edhe ti, apo jo?

- Patjetër e dashur, asnjë s'tha që ka. Por sa për atë që s'ka shumë njerëz në këtë zonë, pak zona kanë më shumë se kaq. Ne kemi hyrje-dalje me njëzet e katër familje.

Z. Bingli arriti ta mbajë veten vetëm për hir të Elizabetës. E motra nuk qe aq e kujdesshme dhe i hodhi

z. Darsit një vështrim të shoqëruar me një buzëqeshje shumë domethënëse. Elizabeta duke dashur ta largonte t'ëmën nga kjo temë, e pyeti nëse Sharlot Lukas kishte qenë në Longborn pas largimit të saj.

- Po, erdhi me të atin dje. Sa burrë i mirë është sër Uilliam z. Bingli, apo jo? Sa burrë i kohës! Sa xhentil, sa i afruar! E gjen një fjalë për të gjithë. Për mua këtu duket edukata. Ata që e mbajnë veten për kushedi se çfarë dhe rrijnë gojëkçur, kanë një koncept të gabuar.

- Ndenji për drekë Sharlota?

- Jo, donte të shkonte në shtëpi. Më duket se e kërkonin për të bërë një lakror me zonjushën. Unë, z. Bingli, mbaj vetëm shërbyesë që dinë ta bëjnë punën. Edhe vajzat i kam rritur ndryshe. Por secili di të gjykojë vetë dhe vajzat e Lukasve janë të mira, as diskutohet. Po gjynah, s'janë të pashme! S'dua të them se Sharlot Lukas është shumë e shëmtuar, sepse e kemi mike.

- Duket vërtet vajzë e mirë, - tha Bingli.

- Po, po. Po e pranoni edhe ju që është shumë e shpëlarë. Vetë lejdi Lukas e ka pohuar dhe ma ka zili bukurinë e Xhejnit. Nuk dua të mburrem për fëmijën tim, por sa për Xhejnin, rrallë sheh më të bukur se ajo. Dhe nuk e them, sepse është vajza ime. Kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç, një zotëri që vizitonte vëllain tim, z. Gardiner, i cili banon në qytet, ra kaq keq në dashuri me të, sa që kunata ime tha se do t'i propozonte para se të largoheshim. Por nuk i propozoi, ndoshta, sepse iu duk akoma e vogël. Sidoqoftë i shkroi disa poezi të cilat ishin goxha të bukura.

- Dhe kështu mori fund dashuria e tij, - u hodh Elizabeta me padurim. - Dhe kështu duhet t'i ketë ardhur fundi dhe shumë të tjerave. S'di kush ia zbuloi poezisë aftësinë që ka për të zbuar dashurinë.

- Unë kam menduar se poezia ushqen dashurinë, - tha z. Darsi.

- Një dashuri të fortë e të qëndrueshme, ndoshta. Vetëm diçka që është vetë e fuqishme mund të ushqehet. Por nëse bëhet fjalë vetëm për një tërheqje të mirëfilltë, jam e sigurtë që një vjershë mjafton për ta asgjësuar.

Darsi vetëm buzëqeshi. Më pas vijoi një heshtje dhe Elizabeta pati frikë që e ëma do ia niste përsëri. Po e hante vendi të thoshte diçka, por s'i vinte asnjë ide. Pas një copë heshtjeje, znj. Benet filloi të falënderonte edhe njëherë z. Binglin për mirësinë që kishte treguar ndaj Xhejnit dhe i kërkoi falje që po e rëndonin edhe me Lizin. Z. Bingli iu përgjigj me një mirësjellje të sinqertë dhe detyroi edhe të motrën të reagoonte me njerëzillëkun që kërkonte situata. Kjo e fundit e luajti rolin pa shumë mjeshtëri, por znj. Benet mbeti e kënaqur dhe pas pak thirri karrocën. Në këtë moment, vajza e saj e vogël u prononcua. Të dyja vajzat kishin qenë gjithë kohën duke pëshpëritur dhe si përfundim më e vogla kishte marrë përsipër t'i kujtonte z. Binglit premtimin për ballon që tha se do të organizonte në Neddherfeld.

Lidia ishte një pesëmbëdhjetëvjeçare e shëndetshme, simpatike dhe gjithmonë në humor. Dobësia, që e ëma kishte për të, kishte bërë që të futej në jetën publike që në moshë të re.<sup>1</sup> Ajo kishte natyrë të hedhur dhe një lloj vetëkënaqësie që ishte shndërruar në vetëbesim, qëkurse kishte fituar admirimin e oficerëve falë darkave të mira që shtronte xhaxhai i saj dhe sjelljes së saj pa dorashka. Kjo pra i jepte të drejtë të fliste me z. Bingli rreth ballos dhe t'i sillte në mendje premtimin e tij, duke shtuar se mosmbajtja e fjalës do të qe gjëja më e paturpshme në botë. Mënyra se si z. Bingli reagoi pas këtij sulmi e ngazëlloi t'ëmën:

---

<sup>1</sup> Normalisht, etiketa e kërkonte që vajzat të ekspozoheshin në shoqëri nga fundi i adoleshencës rreth 18-19 vjeçëve.

- Ju siguroj, që jam në çdo moment gati ta mbaj premtimin dhe kur të shërohet motra juaj, ju lutem caktoni datën. Po s'ma do mendja të doni të kërceni sa kohë që ajo është sëmurë.

Lidia mbeti e kënaqur.

- Po, po. Presim më mirë deri sa të shërohet Xhejni. Atëherë ndoshta është kthyer dhe kolonel Karteri në Meriton. Dhe pas ballos suaj, - vazhdoi ajo, - do këmbëngul që të japin edhe ata një. Do t'i them kolonel Fosterit që do ishte gjynah të mos na ofronte një edhe ai.

Znj. Benet u nis me të bijat, ndërsa Elizabeta u kthye pa humbur kohë te Xhejni, duke e lënë sjelljen e vet dhe të familjes së saj në mëshirën e komenteve të dy zonjave dhe z. Darsit. Ky i fundit nuk pranoi të merrte pjesë në keqtrajtimin e zonjushës Eliza Benet, pavarësisht nga thumbat që zonjushë Bingli hidhte rreth syve të bukur.

## Kapitulli dhjetë

**D**ita kaloi pak a shumë siç kishte kaluar e djeshmja. Znj. Hërst dhe zonjusha Bingli kishin ndenjur disa orë pranë të sëmurës, e cila dalngadalë po e merrte veten. Në mbrëmje Elizabeta u mblodh me të tjerët në dhomën e ndenjjes. Tavolina ku luanin lu<sup>1</sup> nuk doli. Z. Darsi shkruante një letër dhe zonjusha Bingli i qe ulur pranë për ta ndjekur gjatë shkrimit dhe i tërhiqte vëmendjen vazhdimisht duke i dhënë mesazhe për të motrën. Z. Hërst dhe z. Bingli luanin piké<sup>2</sup>, ndërsa znj. Hërst vëzhgonte lojën.

Elizabeta mori një punë qëndisje dhe po zbavitej goxha duke ndjekur atë që po ndodhte ndërmjet z. Darsit dhe shoqërueses së tij. Lavdërimet e saj pa fund, njëherë rreth shkrimit, pastaj rreth drejtësisë së rreshtave ose gjatësisë së letrës dhe indiferenca me të cilën i priste zotëria ato, krijonin një dialog të çuditshëm duke i konfirmuar Elizabetës mendimin që kishte për secilin.

- Sa do të gëzohet zonjusha Darsi kur ta marrë letrën.  
Z. Darsi nuk foli.

---

<sup>1</sup> Lojë me letra.

<sup>2</sup> Lojë me letra shumë e preferuar në këtë periudhë për dy persona.